



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1697/ 5 prot.

Datë 18.08.2025

V E N D I M
Nr. 1063/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.08.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar shërbime*”, me Nr. REF-51688-06-18-2025, me objekt Loti 1 “*Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi (Catering) në S.U.O.Gj “Mbretëresha Geraldinë”*”, me fond limit: 185,219,458 (njëqind e tetëdhjetë e pesë milion e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ose 1,888,452.88 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e tetë) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*Dajti Park 2007*” SHPK me NIPT K115070003S dhe me adresë: Rruga “Bardhok Biba”, Pallati Trema, Hyrja C, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr. 6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të*

prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.06.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar shërbime”, me Nr. REF-51688-06-18-2025, me objekt Loti 1 “Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi (Catering) në S.U.O.Gj “Mbretëresha Geraldinë”, me fond limit: 185,219,458 (njëqind e tetëdhjetë e pesë milion e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ose 1,888,452.88 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e tetë) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Më datë 27.06.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5488 dhe me nr. 1697/2025 prot., datë 27.06.2025, e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt – ankimi si më poshtë vijon:

Të nderuar, pas shqyrtimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe argumentimit përkatës, paraqesim kërkesën tonë për ndryshim të disa prej pikave të këtij dokumentacioni, si më poshtë:

I. Në pikë 2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit: Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2. Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike në financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të vecanta për kualifikim), kapacitetet teknike (nënpika 1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçantë për kualifikim), si dhe nënpika 3 e seksionit 2.3, pervec “Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor (Agroushqimor)” të kriterëve të vecanta për kualifikim, sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në lotin/et në të cilin/et oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

Komentet tona:

1. Konsiderojmë të papërshtatshëm faktin që është parashikuar vetëm një Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor (Agroushqimor) për të gjitha lotet së bashku, edhe kur bëhet fjalë për institucione me ndjeshmëri të lartë dhe shërbim të përditshëm për 365 ditë në vit me 3 vakte ushqimore në ditë.

2. Kërkojmë që të përcaktohet detyrimisht një specialist i dedikuar për cdo lot, për të garantuar cilësinë dhe sigurinë ushqimore. Një specialist i vetëm nuk mund të mbulojë me efektivitet të plotë dy institucione të ndara fizikisht, për shkak të kufizimeve që përcakton Kodi i punës për orarin dhe ditët e pushimit. Kërkojmë të paktën dy specialistë, që të mund të alternohen për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit edhe në rast mungese, leje, raporti mjekësor etj.

3. Kërkojmë që kriteri kumulativ i nënpikës 3 të seksionit 2.3 (stafi i nevojshëm teknik), të aplikohet në mënyrë identike dhe të barabartë për cdo lot, jo vetëm për disa pozicione specifike.

II. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera: referencë: Pika 2.16 e DST-së.

Në këtë pikë është parashikuar që operatori ekonomik nuk mund të mbështetet në subjekt tjetër për licencën e kategorisë II.1.A.1 (katering), gjë që është në përputhje me rekomandimet e APP dhe AKU. Ne mbështesim plotësisht këtë ndalim.

Megjithatë, kemi vërejtje dhe kërkesa shtesë në lidhje me disa pika të tjera:

1. Në pikën 2.2.1 kërkohet që operatori të paraqesë xhiron vjetore për 3 vitet e fundit, me kusht që për një nga vitet të jetë të paktën sa fondi limit i lotit. Kërkojmë që ky kriter të përfshihet edhe në seksionin 2.16, si kapacitet që nuk mund të huazohet, pasi është direkt i lidhur me stabilitetin financiar të vetë subjektit që do të zbatojë kontratën parashikuar edhe Neni 84 i Ligjit nr. 162/2020 për Prokurimin Publik, mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera në pikën 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

2. Në pikën 2.3.2 kërkohet që operatori të paraqesë certifikatat ISO 22000:2018, 45001 dhe 14001. Këto janë dokumente që lidhen me vetë sistemet e menaxhimit të subjektit që ofron shërbimin, dhe jo me një palë të tretë.

Kërkojmë: Të shtohet në pike 2.16 qartësisht se certifikatat ISO nuk mund të merren hua nga subjekte të tjerë.

3. Në pikën 2.3.3 përcaktohet stafi minimal prej 10 punonjësish sipas profesioneve përkatëse. Jemi kundër që pozicionet Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor, Kuzhinier dhe ndihmës Kuzhinier të plotësohen nëpërmjet mbështetjes në kapacitetet e një subjekti tjetër. Këta janë punonjës të specializuar që duhet të jenë punonjës të rregullt të operatorit ekonomik, me kontratë pune të drejtpërdrejtë dhe të dedikuar për shërbimin e ofruar edhe sipas përcaktimeve të Neni 84 i Ligjit nr. 162/2020 për Prokurimin Publik, mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera, pika 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.

III. Në pikën 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesi, kërkohet:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Shpërndarja e pikëve, për çdo Lot si më poshtë:

Kriteri:

- | | |
|---|---------------------|
| <i>1. Çmimi</i> | <i>70 pikë</i> |
| <i>2. Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi</i> | <i>[0- 10] pikë</i> |
| <i>3. Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm –</i> | <i>[0-10] pikë</i> |

4. Transporti ekologjik

[0-10] pikë

Argumentimi i kriterëve të pikezuara dhe menyra e llogaritjes së pikeve:

1. Çmimi:

70 pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Ok1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2. Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi [0- 10] pike

Argumentim: Ofertuesi duhet të propozojë një plan veprimi për parandalimin e mbetjeve ushqimore. Ky plan përfshin (por pa u kufizuar në):

- *Një analizë e të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve ushqimore;*
- *Kryerjen e matjeve të sasive të mbetjeve ushqimore në mënyrë të vazhdueshme ose periodike (duke u bazuar në kontrata të mëparshme apo analiza empirike profesionale);*
- *Hartimin e strategjive për parandalimin e teprimit të ushqimeve, duke përfshirë (por jo vetëm) garantimin e ruajtjes së ushqimit në kushtet e duhura, magazinim efikas, blerje rregullisht në sasi të duhura të lëndës së parë me të cilat do të përgatiten dietat, angazhim të oferteutit në projekte sociale, etj.*

Kërkesa për planveprimin e Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi është një dokument kryesor në zbatimin e kontratës, i cili do ta shoqërojë deri në fund atë, pasi zbatimi i masave të tilla përbën një element të rëndësishëm në vlerësimin e cilësisë së shërbimit, duke reflektuar angazhimin për efikasitet ekonomik dhe mbrojtje mjedisore.

Parandalimi i gjenerimit të mbetjeve ushqimore përbën një masë të rëndësishme për garantimin e një shërbimi efikas, ekonomik dhe të qëndrueshëm. Në kontekstin e ofrimit të shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, minimizimi i ushqimit të papërdorur ndihmon në uljen e kostove operative, përmirëson higjenën në ambientet spitalore duke shmangur rreziqet nga kontaminimi dhe redukton ndikimin negativ në mjedis. Ofruesit e shërbimit inkurajohen të paraqesin masa konkrete për planifikimin e racioneve, përdorimin optimal të lëndëve të para dhe në përputhje me parimet e prokurimit të gjelbër.

Ushqimi i hedhur përbën një burim të madh ndotjeje, pasi gjatë dekompozimit mbetjet organike çlirojnë gazra serrë, elemente të dëmshëm mjedisor.

Nga ana tjetër, duke qenë se hedhja e ushqimit ka ndikim në aspektin social e etik, inkurajimi i praktikave si dhurimi i ushqimit të paprekur (në kushte të sigurta), bashkëpunimi me OJF për mbështetjen e grupeve vulnerabël, etj., mund të ndihmojë komunitetet në nevojë.

Operatore ekonomike me pervoje ne dhurimin e produkteve ushqimore kane qasje me sociale dhe ndikojne drejteperdrejte ne prokurimin e qendrueshem duke optimizuar shpenzimet me ane te shperndarjes se ushqimeve per kategori sociale ne pamundesi.

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

Vleresimi do te behet si me poshte:

a. Cilesia e planveprimit ne aspektin mjedisor: 0- 5 pike

b. Cilesia e planveprimit ne aspektin social: 0-5 pike

**Vleresimi me pike do te behet duke analizuar perfshirjen e elementeve te argumentimit duke mos u kufizuar ne to. Me 0 pike do te vleresohen operatoret ekonomike te cilet nuk paraqesin fare planveprim ose nje planveprim qe nuk permban asnje te dhene te pershkruar ne argumentim. Ndersa pikezimi 1-5 pike do te behet duke u bazuar ne cilesine dhe pershkrimin te elementeve te argumentimit.*

Komente:

1. Argumentimi i bërë nga Autoriteti Kontraktor është i mbështetur në parime të drejta, por mënyra e vlerësimit dhe pikëzimit është e paqartë, pasi nuk jep ndarje të detajuar për çdo element të përmendur. Për shembull, për aspektin social dhe mjedisor jepen deri në 5 pikë secili, por nuk specifikohet saktësisht se cilat masa marrin 1, 2 apo 5 pikë.

Kërkojmë:

Të bëhet një ndarje më e qartë dhe objektive e elementeve të vlerësimit, për të shmangur vlerësime subjektive dhe interpretim të lirë nga komisioni i vlerësimit.

Të vendosen për secilin nëntregues shembuj konkretë se çfarë përmbajtje dokumentare merr secilën vlerë.

3. Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm – [0-10] pikë

Argumentim: Ofertuesi duhet të zbatojë një plan për reduktimin e ambalazheve të panevojshme dhe përdorimin e paketimit të qëndrueshëm.

Ky plan duhet të përfshijë (por pa u kufizuar në):

- Përpilimin e inventarit të mbetjeve: duke analizuar të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve të tjera (përveç mbetjeve ushqimore);*
- Reduktimin e mbetjeve në blerjen e lëndëve të para, me të cilat do të përgatiten racionet (dietat): zgjedhja e llojit të duhur të paketimit për të reduktuar mbetjet (p.sh. Paketim të ripërdorshëm), paketim të riciklueshëm dhe kthimi i paketimit për ripërdorim vetëm në raste kur kjo është e mundur dhe nuk çënon sigurinë e ushqimit;*

- *Reduktimin e mbetjeve në shërbimin e kateringut: shmangia e artikujve me ambalazh dytësor të panevojshëm ose të tepërt, përdorimi i kontenitorëve që mund të rimbushen (për erëza), etj.*

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

Në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimit të politikave të prokurimit të gjelbër, zgjedhja e llojit të duhur të paketimit gjatë blerjes së produkteve ushqimore përbën një element kyç në reduktimin e mbetjeve dhe ndikimit negativ në mjedis.

Paketimi i thjeshtë, funksional dhe i biodegradueshëm ndihmon në:

- *Reduktimin e volumit të mbetjeve të ambalazhit, të cilat përndryshe përbëjnë një ngarkesë të konsiderueshme për mjedisin, zvogëlimin e përdorimit të materialeve plastike dhe ambalazheve dytësore (paketime të panevojshme brenda paketimeve), të cilat janë shpesh jo të riciklueshme dhe pa funksion real ruajtës;*
- *Sigurimin e ruajtjes më të mirë të produkteve ushqimore, duke garantuar jetëgjatësi më të madhe, kontroll cilësor dhe mbrojtje ndaj ndotjes apo dëmtimeve gjatë transportit dhe shpërndarjes;*

Vleresimi do të bëhet si më poshtë:

- Plani i veprimit për ambalazhimin e panevojshëm dhe metodologjia e mbledhjes dhe përpunimit të këtij ambalazhi 0-5 pike*

**Vleresimi me pike do të bëhet duke analizuar përfshirjen e elementeve të argumentimit duke mos u kufizuar në to. Me 0 pike do të vlerësohen operatorët ekonomikë të cilët nuk paraqesin fare planveprim ose një planveprim që nuk përmban asnjë të dhënë të përshkruar në argumentim. Ndërsa pikezimi 1-5 pike do të bëhet duke u bazuar në cilësinë dhe përshkrimin të elementeve të argumentimit.*

- Lloji i paketimit i zgjedhur i cili mund të jetë i biodegradueshëm ose i riciklueshëm 5 pike. Nëse për këtë kriter nuk paraqitet asnjë dokument, ose asnjë dokument që të vertetojë se paketimi i propozuar nuk ka elemente pro mjedisore vlerësohet me 0 pike.*

- *Ky kriter do të vlerësohet bazuar në dokumentacion faktik siç është një marrëdhënie e deshmuar me një prodhues apo distributor të paketimeve ushqimore. Në marrëdhënie është me distributor të autorizuar do të vertetohet marrëdhënia e distributorit me prodhuesin. Në aktet provuese duhet të përshkruhet natyra e paketimit nëse është e riciklueshme, e biodegradueshme apo e ndonjë lloji tjetër, miqësore me mjedisin.*

Komente

1. Ky kriter është teknikisht i saktë dhe në përputhje me objektivat e prokurimit të gjelbër, megjithatë mënyra e vlerësimit mbetet në shumë pjesë subjektive.

a. Për shembull: për metodologjinë e mbledhjes dhe përpunimit të ambalazheve (0 - 5 pikë) nuk jepen kriteret se çfarë vlen 1, 3 apo 5 pikë.

b. Për llojin e paketimit (0 ose 5 pikë), kërkohet dokumentacion nga distributorë/prodhues, por nuk specifikohet a do të mjaftojë një deklaratë, apo kërkohet kontratë, marrëveshje, apo etiketim ?

2. Të qartësohet forma e dokumentacionit provues që do të pranohet (p.sh. Marrëveshje, certifikatë për materialin e ambalazhit, broshurë teknike e prodhuesit, etj.), si dhe të përcaktohen kategori të vlerësimit të këtij dokumentacioni në mënyrë graduale (p.sh. Vetëm deklaratë - 1 pikë, marrëveshje me prodhuesin - 3 pikë, kontratë me dokumente teknike - 5 pikë).

3. Referuar Specifikimeve Teknike që vetë AK ka vendosur kemi një mospërputhje duke qenë qe serviria e ushqimit është kërkuar me TABAKA dhe jo paketim.

Të bëhet ky qartësim.

4. Transporti ekologjik [0-10 pike]

Argumentim: Ofertuesi duhet të dëshmojë se shërbimi i transportit të ushqimit deri në ambientet e AK, do të realizohet me mjete transporti me emetime të ulëta, si më poshtë:

- përdorimin e mjeteve të transportit frigoriferik të llojit elektrik ose hibrid ose cdo lloj tjetër automjeti transporti i cili ka emetimin me të ulet të CO₂ të provuar me dokumentacion.

Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për spitale është një proces i përditshëm, me frekuencë të lartë shpërndarje, përdorim të mjeteve transportuese dhe konsum të konsiderueshëm paketimi dhe energjie, duke sjellë ndikime direkte në mjedis.

Kërkesa për përdorimin e mjeteve frigoriferike elektrike/ hibride dhe me pak emetime kontribuon jo vetëm në uljen e ndotjes në mjedisin ku këta mjetë qarkullojnë, por edhe në zvogëlimin e ndotjes globale dhe përmbushjen e objektivave të klimës. Automjeti i propozuar do të levizte minimalisht tre here në ditë për shpërndarjen ushqimore, kështu që frekuenca e levizjes dhe ndotja është relativisht e lartë. Për këtë arsye, automjetet me emetime të ulëta janë me miqësore me mjedisin.

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë, dokumentacionin e kërkuar në pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si dhe:

- Certifikatë të regjistrimit të mjetit me të dhënat teknike (viti, lloji, standarti EURO)

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

- Nëse OE disponon një automjet elektrik vlerësohet me 10 pikë, nëse disponon një mjet hibrid vlerësohet me 5 pikë dhe nëse disponon automjet tjetër me emetim të ulët vlerësohet nga 0 (nëse emetimi është i lartë) deri në 4 pikë.

Komente

1. Kërkesa e automjeteve specifike, e pa kërkuar në specifikime teknike sipas formularit përkatës në DST, vecanërisht me një pikëzim të tillë favorizues, pa një bazë ligjore të qartë kombëtare për ndalimin e qarkullimit të mjeteve të tjera, është problematike. Kontrolli i mjeteve rregullohet nga institucionet përkatëse (D.P.SH.T.R.R.) nëpërmjet kolaudit.

2. Pikëzim nëse Automjeti nuk është Frigoriferik nga 0 deri në 4 pikë është tërësisht i paqartë.

- Sa pikë mer standarti Euro 3, Euro 4, Euro 5 apo Euro 6 ?
- Po nëse Automjeti Frigoriferik është Hibrid e viti 2010 me Standart Euro 4 ose Euro 5 dhe mjeti tjetër me karburant të standartit Euro 6 e Viti 2025 kush merr më shumë pikë ?
- Kush janë normat e lejuara të emetimit të CO2 në republikën e shqipërisë aktualisht ?

3. Kosto e lartë dhe pengesë për konkurrencën:

Detyrimi për të shpenzuar menjëherë nga 40,000 -50 000 Euro (pjesamrës në një lot) ose 80,000-100.000 Euro (dy lote) për mjete frigoriferike elektrike/hibride pa një kontratë të sigurt, është një barrierë e paimagjinueshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, vecanërisht ato më të vegjël.

Kjo shkon drejtpërdrejt ndesh me Nenin 2 të Ligjit Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, vecanërisht pikat që synojnë:

O Nxjitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës së operatorëve ekonomikë (Neni 2, pika c dhe ç).

O Sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues (Neni 2, pika d).

O Rritjen e efikasitetit dhe uljen e shpenzimeve procedurale (Neni 2, pika a dhe b).

- Sa operator të tjerë ekonomik që kryejn shërbime të ngjashme të cilët kanë përfituar tendera për ofrimin e shërbimeve publike kanë të regjistruara sot këto lloj mjeteve ?
- A ka një strategji të caktuar për të orientuar të gjithë këto operatorë që ofrojnë shërbime të ngjashme që të kryejnë investime në flotën e mjeteve elektrike (duke marrë parasysh edhe koston fillestare të lartë që kanë këto mjete) me anë të njoftimeve në faqen e APP-së ?
- A ka një praktik të ndjekur më përpara OBP në lidhje me këtë pikëzim në procedurë të njëjta ?

4. Abuzim dhe mungesë Financimi: Bankat dhe institucionet financiare nuk mund të kreditojnë shuma të tilla pa një plan biznesi dhe një kontratë të nënshkruar. Kjo e bën kërkesën të pamundur për t'u përmbushur dhe tejet abuzive.

5. Sugjerim Alternativ: Propozimi jonë është që subjekti fitues të marrë angazhimin për t'u pajisur me një mjet me emetime të ulëta CO2 brenda një kohe të caktuar (p.sh., në Planin e Zbatimit të kontratës të vendoset si detyrim) është një qasje shumë më e arsyeshme dhe e zbatueshme.

Kjo do të ndihmonte në arritjen e objektivave mjedisore pa krijuar barriera të padrejta konkurrence.

IV. Kërkesë për përmirësim të qasjes metodologjike sipas Ligjit Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, neni 87 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese në të gjitha pikat e tij:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të cmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, sic janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë cmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një cmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në cdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve;

ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep cdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të

favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e cmimit. Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

1. Të bëhet një rishimim i metodologjisë së përgatitjes së ofertës në zbatim të specifikimeve teknike dhe bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme duke shtuar minimalisht eksperincën e Stafit që do të kryej shërbimin.

- A nuk është staf i teknik pjesa më e rëndësishme e përgatitjes së të gjithë shërbimit të kërkuar duke e garantuar cilësinë dhe shërbimin me sukses sikurse parashikon udhrrëfyesi i APP, sipas pikës kriteri i vlerësimit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto” ?

2. Të bëhet qartësim metodologjik për cdo nëntregues të vlerësimit përfshirë shembuj konkretë për vlerësimin 1 - 5 pikë.

3. Të përcaktohet saktësisht forma dhe tipi i dokumentacionit provues që do të pranohet për cdo kriter.

4. Të shmangët cdo marrje vendimi mbi bazë perceptimi dhe të garantohet një proces transparent dhe i barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

5. Autoriteti Kontraktor nuk ka respektuar udhëzimet e përcaktuara në Aneksin 2, i cili shërben si një orientues i rëndësishëm për procesin e pikëzimit, duke mos dhënë pikëzim në përputhje me të.

6. Ne pajtohemi që paketimi ekologjik, reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe plani i veprimit për gjenerimin e mbetjeve janë elementë të rëndësishëm. Megjithatë, pjesa më kritike e procesit përfundimtar mbetet menaxhimi dhe eliminimi i mbetjeve, pavarësisht sasisë së tyre, dhe duhet trajtuar me prioritet.

7. Sugjerojmë që Autoriteti Kontraktor të kërkojë nga operatorët ekonomikë edhe dokumentacion ligjor të lidhur me menaxhimin e mbetjeve si një masë shtesë sigurie për respektimin e standardeve mjedisore.

8. Nuk jemi dakord që peshorja e pikëzimit për këtë kriter të jetë kaq e rëndësishme dhe të lihet në dorë të Komisionit të vlerësimit (KVO) për vlerësim subjektiv sipas rastit, pasi kjo sjell rrezikun e mungesës së transparencës dhe padrejtësisë.

9. Cdo subjekt pjesëmarrës në një procedurë prokurimi është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore në fuqi, përfshirë ato në fushën mjedisore.

10. Institucionet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit në fushën e punës, sigurisë ushqimore dhe ambientit kanë inspektoriatet dhe specialistët përkatës që kryejnë kontrolle dhe verifikime për respektimin e rregullave ligjore.

A. Vetë Licenca II.1.A.1 për Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz përfshin kontroll të dyfishtë vjetor nga Agjencia e Kontrollit Ushqimor (AKU), e cila vlerëson respektimin e kriterëve ligjore për kontrollin dhe zbatimin e planit HACCP.

11. Kërkojmë që të rishikohet formulimi i pikëzimit për këtë kriter, pasi aktualisht mungesa e qartësisë dhe specifikimit të tij shkakton mungesë transparence dhe trajtim të pabarabartë ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke sjellë konfuzion në procesin e vlerësimit.

V. Në Seksionin 2 Kriteret Vecanta të Kualifikimit, kërkohet:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë licencë të kategorisë III.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëzë, (katering). Nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

2.1.2 operatorët ekonomikë, duhet të posedojnë të paktën 1 (një) stabiliment të licensuar për prodhimin e ushqimit. Ky stabiliment duhet të jetë brenda bashkisë/ ku do të zbatohet marrëveshja kuadër. Objekti mund të jetë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregulimeve ligjore. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratë qiraje ose përdorimi, ku të identifikohet dhe vendndodhja brenda bashkisë.

- Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të paraqitet nga secili prej anëtareve të BOE.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

- Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtareve të BOE.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të plotësohet në bazë të përqindjes që marrin përsipër secili prej anëtareve të BOE.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë:

SH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;

- Kërkojmë të shtohet: Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i Akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të paraqitet nga secili prej anëtareve të BOE.

2.3.3 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1.	Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor (<u>Agroushqimor</u>)	1
2.	Kuzhinier	1
3.	Ndihmës Kuzhinier	1
4.	Punonjës shpërndarës ushqimesh në ambientet e AK	6
5.	Shofer	1
	Total	10 (dhjetë)

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor (Agroushqimor), Kuzhinierin, Ndihmës Kuzhinierin, Punonjës shpërndarës ushqimesh në ambientet e AK.

a) **Mercolog/Kimist/ Teknolog Ushqimor (Agroushqimor):**

- Diplomë me profesionin perkates:
- Kontratë pune (e vlefshme),
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtareve të BOE.

b) Për Kuzhinierin:

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi për kuzhinier në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional,
- Kontratë pune si kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtareve të BOE.

c) Për ndihmës kuzhinierin:

- Kontratë pune si ndihmës kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 një vit.

Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtareve të BOE.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje/përdorimi/shërbimi, dhe leje qarkullimi, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore si dhe të jetë i shoqëruar me certifikatën për plotësimin e kushteve teknike.

Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtareve të BOE dhe të shtohet që në rast se mjeti kalon kapacitetin mbajtës mbi 1.5 Ton të paraqesë edhe certifikatën e transportit të mallrave sipas përcaktimeve ligjore.

Në rast të mjetit me qira kontrata duhet të mbuloj afatin e kontratës.

Si përfundim kërkojmë:

- 1. Përzullimin e procedurës nga Operatori i Blerjeve të përqëndruara sh.a deri në vendimarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 2. Pranimin e kërkesës nga Operatori i Blerjeve të përqëndruara sh.a dhe Komisioni i Prokurimit Publik.*
- 3. Ndryshimin e Dokumentave Standarte të Tenderit sipas të gjitha kërkesave tona.*

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 1885/11, datë 02.07.2025, (ardhur nëpërmjetë shërbimit postar) protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 1697/1 prot, datë 03.07.2025, me objekt “*Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik Dajti Park 2007 shpk lidhur me dokumentet e tenderit në procedurën e prokurimit me nr. Ref-51688-06-18-2025, me objekt Loti 1 Gatim dhe shpërndarje ushqimi Catering në SUOGJ Mbretëresha Geraldinë*”, autoriteti kontraktor ka dërguar vendimin nr. 57/2025, datë 01.07.2025 ku pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.5. Me shkresën nr. 2511 prot, datë 11.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 1697/2 prot, datë 12.08.2025 autoriteti kontraktor ka kërkuar përsheptimin e shqyrtimit të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK të parashtruara në formularin e ankesës të ankesës me numër ankimi elektronik A/2025/5487 dhe me nr. 1697/2025 prot., datë 27.06.2025, si në vijim: “1. Konsiderojmë të papërshtatshëm faktin që është parashikuar vetëm një Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor (Agroushqimor) për të gjitha lotet së bashku, edhe kur bëhet fjalë për institucione me ndjeshmëri të lartë dhe shërbim të përditshëm për 365 ditë në vit me 3 vakte ushqimore në ditë. 2. Kërkojmë që të përcaktohet detyrimisht një specialist i dedikuar për çdo lot, për të garantuar cilësinë dhe sigurinë ushqimore. Një specialist i vetëm nuk mund të mbulojë me efektivitet të plotë dy institucione të ndara fizikisht, për shkak të kufizimeve që përcakton Kodi i Punës për orarin dhe ditët e pushimit. Kërkojmë të paktën dy specialistë, që të mund të

alternohen për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit edhe në rast mungese, leje, raporti mjekësor etj. 3. Kërkojmë që kriteri kumulativ i nënpikës 3 të seksionit 2.3 (stafi i nevojshëm teknik), të aplikohet në mënyrë identike dhe të barabartë për çdo lot, jo vetëm për disa pozicione specifike. 4. Në pikën 2.2.1 kërkohet që operatori të paraqesë xhiron vjetore për 3 vitet e fundit, me kusht që për një nga vitet të jetë të paktën sa fondi limit i lotit. Kërkojmë që ky kriter të përfshihet edhe në seksionin 2.16, si kapacitet që nuk mund të huazohet, pasi është direkt i lidhur me stabilitetin financiar të vetë subjektit që do të zbatojë kontratën parashikuar edhe Neni 84 i Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera në pikën 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes. 5. Në pikën 2.3.2 kërkohet që operatori të paraqesë certifikatat ISO 22000:2018, 45001 dhe 14001. Këto janë dokumente që lidhen me vetë sistemet e menaxhimit të subjektit që ofron shërbimin, dhe jo me një palë të tretë. Kërkojmë: Të shtohet në pike 2.16 qartësisht se certifikatat ISO nuk mund të merren hua nga subjekte të tjerë. 6. Në pikën 2.3.3 përcaktohet stafi minimal prej 10 punonjësish sipas profesioneve përkatëse. Jemi kundër që pozicionet Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor, Kuzhinier dhe Ndihmës Kuzhinier të plotësohen nëpërmjet mbështetjes në kapacitetet e një subjekti tjetër. Këta janë punonjës të specializuar që duhet të jenë punonjës të rregullt të operatorit ekonomik, me kontratë pune të drejtpërdrejtë dhe të dedikuar për shërbimin e ofruar edhe sipas përcaktimeve të Neni 84 i Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera, pika 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues. 1. Të bëhet një rishikim i metodologjisë së përgatitjes së ofertës në zbatim të Specifikimeve Teknike dhe bazuar në ofertën ekonomike më të favorshme duke shtuar minimalisht Eksperincën e Stafit që do të kryej shërbimin. - A Nuk është stafi teknik pjesa më e rëndësishme e përgatitjes së të gjithë shërbimit të kërkuar duke e garantuar cilësinë dhe shërbimin me sukses sikurse parashikon UDHRREFYESI i APP, sipas Pikës Kriteri i vlerësimit “oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto”? 7. Sugjerojmë që Autoriteti Kontraktor të kërkojë nga operatorët ekonomikë edhe dokumentacion ligjor të lidhur me menaxhimin e mbetjeve si një masë shtesë sigurie për respektimin e standardeve mjedisore. IV. Në Seksionin 2 KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, kërkohet: 2.1.2 Operatorët ekonomikë, duhet të posedojnë të paktën 1 (një) stabiliment të licensuar për prodhimin e ushqimit. Ky stabiliment duhet të jetë brenda bashkisë/ ku do të zbatohet marrëveshja kuadër. Objekti mund të jetë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratë qiraje ose përdorimi, ku të identifikohet dhe vendndodhja brenda bashkisë. Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të paraqitet nga secili prej anëtarëve të BOE. 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të

lotit. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar. Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtareve të BOE. 2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të plotësohet në bazë të përqindjes që marrin përsipër secili prej anëtareve të BOE. 2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë: SH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigorisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme; Kërkojmë të shtohet: Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të paraqitet nga secili prej anëtareve të BOE. S SH EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigorisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme; Kërkojmë të shtohet: Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të paraqitet nga secili prej anëtareve të BOE. SSH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme; Kërkojmë të shtohet pika: Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe që në rastin e BOE ky kriter duhet të paraqitet nga secili prej anëtareve të BOE. 2.3.3

Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

<u>Nr.</u>	<u>Profesioni</u>	<u>Numri i punonjësve</u>
<u>1.</u>	<u>Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor</u> <u>(Agroushqimor)</u>	<u>1</u>
<u>2.</u>	<u>Kuzhinier</u>	<u>1</u>
<u>3.</u>	<u>Ndihmës Kuzhinier</u>	<u>1</u>
<u>4.</u>	<u>Punonjës shpërndarës ushqimesh në ambientet e AK</u>	<u>6</u>
<u>5.</u>	<u>Shofer</u>	<u>1</u>
	<u>Total</u>	<u>10 (dhjetë)</u>

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor (Agroushqimor), Kuzhinierin, Ndihmës Kuzhinierin, Punonjës shpërndarës ushqimesh në ambientet e AK. a) Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor (Agroushqimor): - Diplomë me profesionin perkates: - Kontratë pune (e vlefshme), - Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite. Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtareve të BOE. b) Për Kuzhinierin: - Diplomë ose certifikatë kualifikimi për kuzhinier në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional, - Kontratë pune si kuzhinier, (e vlefshme), - Librezë pune/deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite. Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtareve të BOE. c) Për ndihmës kuzhinierin: d) - Kontratë pune si ndihmës kuzhinier, (e vlefshme) - Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 një vit. Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtareve të BOE. 2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje/përdorimi/shërbimi, dhe leje qarkullimi, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore si dhe të jetë i shoqëruar me certifikatën për plotësimin e kushteve teknike. Kërkojmë të shtohet pika që në rastin e BOE ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtareve të BOE dhe të shtohet që në rast se mjeti kalon kapacitetin mbajtës mbi 1.5 Ton të paraqesë edhe Certifikatën e Transportit të Mallrave sipas përcaktimeve Ligjore. Në rast të mjetit me qira kontrata duhet të mbulojë afatin e kontratës. Të bëhet një rishimim i metodologjisë së përgatitjes së ofertës në zbatim të specifikimeve teknike dhe bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme duke shtuar minimalisht eksperincën e Stafit që do të kryej shërbimin. A nuk është stafi teknik pjesa më e rëndësishme e përgatitjes së të gjithë shërbimit të kërkuar duke e garantuar cilësinë dhe shërbimin me sukses sikurse parashikon udhrrëfyeti i APP, sipas pikës kriteri i vlerësimit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto” ? Sugjerojmë që Autoriteti Kontraktor të kërkojë nga operatorët ekonomikë edhe dokumentacion ligjor të lidhur me menaxhimin e mbetjeve si një masë shtesë sigurie për respektimin e standardeve mjedisore”, Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se këto pretendime në thelb kanë të bëjnë me shtim të kriteve të kualifikimit dhe jo me pretendime për modifikimin e kriteve diskriminuese, të cilat do të shkaktonin skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së)

dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”. KPP gjykon, se që të justifikohet ligjërisht kërkitimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar, duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuar (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve për kualifikim pranë këtij të fundit, duke u dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurat për fitimin e kontratave publike, do t'i nënshtrohen kushteve specifike, të cilat duhet të përmbushin parakushtin të parashikuar nga neni 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Në rastin konkret, KPP gjykon, se njësisia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësimit të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 118 pika 2 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik, janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kriterë kualifikimi ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri i kualifikimit është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se kriteret e kualifikimit janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, pasi përcaktimi i kriterëve të kualifikimit sipas kërkesës nga ankimuesi, konsiderohen kriterë të reja që do të rëndonin pozitën e operatorëve ekonomik të interesuar.

Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar, se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret të shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës

pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar të vendosë kriteret e kualifikimit sipas propozimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit), të shtojë kritere kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik.

Sa më sipër, këto pretendime të operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Dajti Park 2007*” SHPK për modifikimin e dokumentave standarte të tenderit sa i përket kriterit për vlerësimin me pikë i cili argumenton se: *Në pikën 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesi, kërkohet: A) Oferta ekonomiksht më e favorshme, bazuar në kosto X. Shpërndarja e pikëve, për çdo Lot si më poshtë: Kriteri: Çmimi 70 pikë; Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi [0- 10] pikë; Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm [0-10] pikë; Transporti ekologjik [0-10] pikë. Argumentimi i kriterëve të pikezuara dhe menyra e llogaritjes së pikeve: Çmimi: 70 pikë. Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij. Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës: $Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$; $Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet; $Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet; $Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet; $Ok1$ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet. Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi [0- 10] pike. Argumentim: Ofertuesi duhet të përpilojë një plan veprimi për parandalimin e mbetjeve ushqimore. Ky plan përfshin (por pa u kufizuar në): Një analizë e të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve ushqimore; Kryerjen e matjeve të sasive të mbetjeve ushqimore në mënyrë të vazhdueshme ose periodike (duke u bazuar në kontrata të mëparshme apo analiza empirike profesionale); Hartimin e strategjive për parandalimin e teprimit të ushqimeve, duke përfshirë (por jo vetëm) garantimin e ruajtjes së ushqimit në kushtet e duhura, magazinim efikas, blerje rregullisht në sasi të duhura të lëndës së parë me të cilat do të përgatiten dietat, angazhim të oferteusit në projekte sociale, etj. Kërkesa për planveprimin e Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi është një dokument kryesor në zbatimin e kontratës, i cili do ta shoqërojë deri në fund atë, pasi zbatimi i masave të tilla përbën një element të rëndësishëm në vlerësimin e cilësisë së shërbimit, duke reflektuar angazhimin për efikasitet ekonomik dhe mbrojtje mjedisore. Parandalimi i gjenerimit të mbetjeve ushqimore përbën një masë të rëndësishme për garantimin e një shërbimi efikas, ekonomik dhe të qëndrueshëm. Në kontekstin e ofrimit të shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, minimizimi i ushqimit të papërdorur ndihmon në uljen e kostove operative, përmirëson higjenën në ambientet spitalore duke shmangur rreziqet nga kontaminimi dhe redukton ndikimin negativ në mjedis. Ofruesit e shërbimit inkurajohen të paraqesin masa konkrete për planifikimin e racioneve, përdorimin optimal të lëndëve të para dhe në përputhje me parimet e prokurimit të gjelbër. Ushqimi i hedhur përbën një burim të madh ndotjeje, pasi gjatë dekompozimit mbetjet organike çlirojnë gazra serrë, elemente të dëmshëm mjedisor. Nga ana tjetër, duke qenë se hedhja e ushqimit ka ndikim në aspektin social e etik, inkurajimi i praktikave si dhurimi i ushqimit të paprekur (në kushte të sigurta), bashkëpunimi me OJF për mbështetjen e grupeve vulnerabël, etj., mund të ndihmojë komunitetet në nevojë. Operatore ekonomike me përvorje në dhurimin e produkteve ushqimore kanë qasje me sociale dhe*

ndikojne drejteperdrejte ne prokurimin e qendrueshem duke optimizuar shpenzimet me ane te shperndarjes se ushqimeve per kategori sociale ne pamundesit. Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to. Vleresimi do te behet si me poshte: Cilesia e planveprimit ne aspektin mjedisor: 0- 5 pike; Cilesia e planveprimit ne aspektin social: 0-5 pike. *Vleresimi me pike do te behet duke analizuar perfshirjen e elementeve te argumentimit duke mos u kufizuar ne to. Me 0 pike do te vleresohen operatoret ekonomike te cilet nuk paraqesin fare planveprim ose nje planveprim qe nuk permбан asnje te dhene te pershkruar ne argumentim. Ndersa pikezimi 1-5 pike do te behet duke u bazuar ne cilesine dhe pershkrimin te elementeve te argumentimit. **Komente:** 1. Argumentimi i bërë nga Autoriteti Kontraktor është i mbështetur në parime të drejta, por mënyra e vlerësimit dhe pikëzimit është e paqartë, pasi nuk jep ndarje të detajuar për cdo element të përmendur. Për shembull, për aspektin social dhe mjedisor jepen deri në 5 pikë secili, por nuk specifikohet saktësisht se cilat masa marrin 1, 2 apo 5 pikë. **Kërkojmë:** Të bëhet një ndarje më e qartë dhe objektive e elementeve të vlerësimit, për të shmangur vlerësime subjektive dhe interpretim të lirë nga komisioni i vlerësimit. Të vendosen për secilin nëntregues shembuj konkretë se çfarë përmbajtje dokumentare merr secilën vlerë. Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm [0-10] pikë. Argumentim: Ofertuesi duhet të zbatojë një plan për reduktimin e ambalazheve të panevojshme dhe përdorimin e paketimit të qëndrueshëm. Ky plan duhet të përfshijë (por pa u kufizuar në): Përpilimin e inventarit të mbetjeve: duke analizuar të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve të tjera (përveç mbetjeve ushqimore); Reduktimin e mbetjeve në blerjen e lëndëve të para, me të cilat do të përgatiten racionet (dietat): zgjedhja e llojit të duhur të paketimit për të reduktuar mbetjet (p.sh. Paketim të ripërdorshëm), paketim të riciklueshëm dhe kthimi i paketimit për ripërdorim vetëm në raste kur kjo është e mundur dhe nuk cënon sigurinë e ushqimit; Reduktimin e mbetjeve në shërbimin e kateringut: shmangia e artikujve me ambalazh dytësor të panevojshëm ose të tepërt, përdorimi i kontenitorëve që mund të rimbushen (për erëza), etj. Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to. Në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimit të politikave të prokurimit të gjelbër, zgjedhja e llojit të duhur të paketimit gjatë blerjes së produkteve ushqimore përbën një element kyç në reduktimin e mbetjeve dhe ndikimit negativ në mjedis. Paketimi i thjeshtë, funksional dhe i biodegradueshëm ndihmon në: • Reduktimin e volumit të mbetjeve të ambalazhit, të cilat përndryshe përbëjnë një ngarkesë të konsiderueshme për mjedisin, zvogëlimin e përdorimit të materialeve plastike dhe ambalazheve dytësore (paketime të panevojshme brenda paketimeve), të cilat janë shpesh jo të riciklueshme dhe pa funksion real ruajtës; • Sigurimin e ruajtjes më të mirë të produkteve ushqimore, duke garantuar jetëgjatësi më të madhe, kontroll cilësor dhe mbrojtje ndaj ndotjes apo dëmtimeve gjatë transportit dhe shpërndarjes; Vleresimi do te behet si me poshte: Plani i veprimit per ambalazhimin e panevojshem dhe metodologjia e mbledhjes dhe perpunimit te ketij ambalazhi 0-5 pike. Vleresimi me pike do te behet duke analizuar perfshirjen e elementeve te argumentimit duke mos u kufizuar ne to. Me 0 pike do te vleresohen operatoret ekonomike te cilet nuk paraqesin fare planveprim ose nje planveprim qe nuk permбан asnje te dhene te pershkruar ne argumentim. Ndersa pikezimi 1-5 pike do te

behët duke u bazuar në cilësinë dhe përshkrimin të elementeve të argumentimit. Lloji i paketimit i zgjedhur i cili mund të jetë i biodegradueshem ose i riciklueshem 5 pike. Nëse për këtë kriter nuk paraqitet asnjë dokument, ose asnjë dokument që të vertetojë se paketimi i propozuar nuk ka elemente pro mjedisore vlerësohet me 0 pike. Ky kriter do të vlerësohet bazuar në dokumentacion faktik sic është një marrëdhënie e deshmuar me një prodhues apo distributor të paketimeve ushqimore. Në marrëdhënie është me distributor të autorizuar do të vertetohet marrëdhënia e distributorit me prodhuesin. Në aktet provuese duhet të përshkruhet natyra e paketimit nëse është e riciklueshme, e biodegradueshme apo e ndonjë lloji tjetër, miqësore me mjedisin. **Komente:** 1. Ky kriter është teknikisht i saktë dhe në përputhje me objektivat e prokurimit të gjelbër, megjithatë mënyra e vlerësimit mbetet në shumë pjesë subjektive. a. Për shembull: për metodologjinë e mbledhjes dhe përpunimit të ambalazheve (0 - 5 pikë) nuk jepen kriteret se çfarë vlen 1, 3 apo 5 pikë. b. Për llojin e paketimit (0 ose 5 pikë), kërkohet dokumentacion nga distributorë/prodhues, por nuk specifikohet a do të mjaftojë një deklaratë, apo kërkohet kontratë, marrëveshje, apo etiketim ?. 2. Të qartësohet forma e dokumentacionit provues që do të pranohet (p.sh. Marrëveshje, certifikatë për materialin e ambalazhit, broshurë teknike e prodhuesit, etj.), si dhe të përcaktohen kategori të vlerësimit të këtij dokumentacioni në mënyrë graduale (p.sh. Vetëm deklaratë - 1 pikë, marrëveshje me prodhuesin - 3 pikë, kontratë me dokumente teknike - 5 pikë). 3. Referuar Specifikimeve Teknike që vetë AK ka vendosur kemi një mospërputhje duke qenë që serviria e ushqimit është kërkuar me TABAKA dhe jo paketim. Të bëhet ky qartësim. Transporti ekologjik [0-10 pike]. Argumentim: Ofertuesi duhet të dëshmojë se shërbimi i transportit të ushqimit deri në ambientet e AK, do të realizohet me mjete transporti me emetime të ulëta, si më poshtë: - përdorimin e mjeteve të transportit frigoriferik të llojit elektrik ose hibrid ose cdo lloj tjetër automjeti transporti i cili ka emetimin më të ulët të CO₂ të provuar me dokumentacion. Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për spitale është një proces i përditshëm, me frekuencë të lartë shpërndarje, përdorim të mjeteve transportuese dhe konsum të konsiderueshëm paketimi dhe energjie, duke sjellë ndikime direkte në mjedis. Kërkesa për përdorimin e mjeteve frigoriferike elektrike/ hibride dhe me pak emetime kontribuon jo vetëm në uljen e ndotjes në mjedisin ku këta mjete qarkullojnë, por edhe në zvogëlimin e ndotjes globale dhe përmbushjen e objektivave të klimës. Automjeti i propozuar do të levizë minimalisht tre here në ditë për shpërndarjen ushqimore, kështu që frekuenca e levizjes dhe ndotja është relativisht e lartë. Për këtë arsye, automjetet me emetime të ulëta janë me miqësore me mjedisin. Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë, dokumentacionin e kërkuar në pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si dhe: Certifikatë të regjistrimit të mjetit me të dhënat teknike (viti, lloji, standarti EURO). Vlerësimi do të bëhet si më poshtë: Nëse OE disponon një automjet elektrik vlerësohet me 10 pikë, nëse disponon një mjet hibrid vlerësohet me 5 pikë dhe nëse disponon automjet tjetër me emetim të ulët vlerësohet nga 0 (nëse emetimi është i lartë) deri në 4 pikë. **Komente:** 1. Kërkesa e automjeteve specifike, e pa kërkuar në specifikime teknike sipas formularit përkatës në DST, vëcanërisht me një pikëzim të tillë favorizues, pa një bazë ligjore të qartë kombëtare për ndalimin e qarkullimit të mjeteve të tjera, është problematike. Kontrolli i mjeteve rregullohet nga institucionet përkatëse (D.P.SH.T.R.R.) nëpërmjet kolaudit. 2. Pikëzim nëse Automjeti nuk është Frigoriferik nga 0 deri në 4 pikë është tërësisht i paqartë. - Sa pikë mer standarti Euro 3, Euro 4, Euro 5 apo Euro 6 ?. - Po nëse Automjeti Frigoriferik

është Hibrid e viti 2010 me Standart Euro 4 ose Euro 5 dhe mjeti tjetër me karburant të standartit Euro 6 e Viti 2025 kush merr më shumë pikë ?. - Kush janë normat e lejuara të emetimit të CO2 në republikën e shqipërisë aktualisht ?. 3. Kosto e lartë dhe pengesë për konkurrencën: Detyrimi për të shpenzuar menjëherë nga 40,000 -50 000 Euro (pjesamrës në një lot) ose 80,000-100.000 Euro (dy lote) për mjete frigoriferike elektrike/hibride pa një kontratë të sigurt, është një barrierë e paimagjinueshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, vecanërisht ato më të vegjël. Kjo shkon drejtpërdrejt ndesh me Nenin 2 të Ligjit Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, vecanërisht pikat që synojnë: Nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës së operatorëve ekonomikë (Neni 2, pika c dhe ç). Sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues (Neni 2, pika d). Rritjen e efikasitetit dhe uljen e shpenzimeve procedurale (Neni 2, pika a dhe b). Sa operator të tjerë ekonomik që kryejn shërbime të ngjashme të cilët kanë përfutur tendera për ofrimin e shërbimeve publike kanë të regjistruara sot këto lloj mjeteve ?. A ka një strategji të caktuar për të orientuar të gjithë këto operatorë që ofrojnë shërbime të ngjashme që të kryejnë investime në flotën e mjeteve elektrike (duke marrë parasysh edhe koston fillestare të lartë që kanë këto mjete) me anë të njoftimeve në faqen e APP-së ?. A ka një praktik të ndjekur më përpara OBP në lidhje me këtë pikëzim në proçerura të njëjta ?. 4. Abuzim dhe mungesë Financimi: Bankat dhe institucionet financiare nuk mund të kreditojnë shuma të tilla pa një plan biznesi dhe një kontratë të nënshkruar. Kjo e bën kërkesën të pamundur për t'u përmbushur dhe tejet abuzive. 5. Sugjerim Alternativ: Propozimi jonë është që subjekti fitues të marrë angazhimin për t'u pajisur me një mjet me emetime të ulëta CO2 brenda një kohe të caktuar (p.sh., në Planin e Zbatimit të kontratës të vendoset si detyrim) është një qasje shumë më e arsyeshme dhe e zbatueshme. Kjo do të ndihmonte në arritjen e objektivave mjedisore pa krijuar barriera të padrejta konkurrence. IV. Kërkesë për përmirësim të qasjes metodologjike sipas Ligjit Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, neni 87 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese në të gjitha pikat e tij: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme. 2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të cmimit ose koston, duke përdorur metodën e efektivitetit të koston, sic janë koston gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë cmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Kriteret të tilla mund të përfshijnë: a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i koston, gjithashtu, mund të marrë formën e një cmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë. 3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në cdo drejtim dhe në cdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në: a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose

shërbimeve; ose b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep cdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e cmimit. Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës. 2. Të bëhet qartësim metodologjik për cdo nëntregues të vlerësimit përfshirë shembuj konkretë për vlerësimin 1 - 5 pikë. 3. Të përcaktohet saktësisht forma dhe tipi i dokumentacionit provues që do të pranohet për cdo kriter. 4. Të shmanget cdo marrje vendimi mbi bazë perceptimi dhe të garantohet një proces transparent dhe i barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë. 5. Autoriteti Kontraktor nuk ka respektuar udhëzimet e përcaktuara në Aneksin 2, i cili shërben si një orientues i rëndësishëm për procesin e pikëzimit, duke mos dhënë pikëzim në përputhje me të. 6. Ne pajtohemi që paketimi ekologjik, reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe plani i veprimit për gjenerimin e mbetjeve janë elementë të rëndësishëm. Megjithatë, pjesa më kritike e procesit përfundimtar mbetet menaxhimi dhe eliminimi i mbetjeve, pavarësisht sasisë së tyre, dhe duhet trajtuar me prioritet. 8. Nuk jemi dakord që peshorja e pikëzimit për këtë kriter të jetë kaq e rëndësishme dhe të lihet në dorë të Komisionit të vlerësimit (KVO) për vlerësim subjektiv sipas rastit, pasi kjo sjell rrezikun e mungesës së transparencës dhe padrejtësisë. 9. Cdo subjekt pjesëmarrës në një procedurë prokurimi është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore në fuqi, përfshirë ato në fushën mjedisore. 10. Institucionet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit në fushën e punës, sigurisë ushqimore dhe ambientit kanë inspektoriatet dhe specialistët përkatës që kryejnë kontrole dhe verifikime për respektimin e rregullave ligjore. A. Vetë Licenca II.1.A.1 për Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz përfshin kontroll të dyfishtë vjetor nga Agjencia e Kontrollit Ushqimor (AKU), e cila vlerëson respektimin e kriterëve ligjore për kontrollin dhe zbatimin e planit HACCP. 11. Kërkojmë që të rishikohet formulimi i pikëzimit për këtë kriter, pasi aktualisht mungesa e qartësisë dhe specifikimit të tij shkakton mungesë transparence dhe trajtim të pabarabartë ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke sjellë konfuzion në procesin e vlerësimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në seksionin 4 “Procedura” në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”, të dokumenteve standarte të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Shpërndarja e pikëve, për cdo Lot si më poshtë:

Kriteri:

1. **Çmimi** [70] pikë
2. **Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi** [0- 10] pikë

3. *Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm* – [0-10] pikë
4. *Transporti ekologjik* [0-10] pikë

Argumentimi i kriterëve të pikezuara dhe menyrat e llogaritjes së pikëve:

1. Çmimi: 70 pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

$Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

$Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2. Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi [0- 10] pike

Argumentim: Ofertuesi duhet të propozojë një plan veprimi për parandalimin e mbetjeve ushqimore. Ky plan përfshin (por pa u kufizuar në):

- një analizë e të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve ushqimore;
- kryerjen e matjeve të sasive të mbetjeve ushqimore në mënyrë të vazhdueshme ose periodike (duke u bazuar në kontratat e mëparshme apo analiza empirike profesionale);
- hartimin e strategjive për parandalimin e teprimit të ushqimeve, duke përfshirë (por jo vetëm) garantimin e ruajtjes së ushqimit në kushtet e duhura, magazinim efikas, blerje rregullisht në sasi të duhura të lëndës së parë me të cilat do të përgatiten dietat, angazhim të oferteutit në projekte sociale, etj.

Kërkesa për planveprimin e Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi është një dokument kryesor në zbatimin e kontratës, i cili do të shoqërohet deri në fund të, pasi zbatimi i masave të tilla përbën një element të rëndësishëm në vlerësimin e cilësisë së shërbimit, duke reflektuar angazhimin për efikasitet ekonomik dhe mbrojtje mjedisore.

Parandalimi i gjenerimit të mbetjeve ushqimore përbën një masë të rëndësishme për garantimin e një shërbimi efikas, ekonomik dhe të qëndrueshëm. Në kontekstin e ofrimit të shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, minimizimi i ushqimit të papërdorur ndihmon në uljen e kostove operative, përmirëson higjienën në ambientet spitalore duke shmangur rreziqet nga kontaminimi dhe redukton ndikimin negativ në mjedis. Ofruesit e shërbimit inkurajohen të paraqesin masa konkrete për planifikimin e racioneve, përdorimin optimal të lëndëve të para dhe në përputhje me parimet e prokurimit të gjelbër.

Ushqimi i hedhur përbën një burim të madh ndotjeje, pasi gjatë dekompozimit mbetjet organike çlirojnë gazra serrë, elemente të dëmshëm mjedisor.

Nga ana tjetër, duke qenë se hedhja e ushqimit ka ndikim në aspektin social e etik, inkurajimi i praktikave si dhurimi i ushqimit të paprekur (në kushte të sigurt), bashkëpunimi me OJF për mbështetjen e grupeve vulnerabël, etj., mund të ndihmojë komunitetet në nevojë. Operatore ekonomike me pervoje në dhurimin e produkteve ushqimore kanë qasje me sociale dhe ndikojnë drejteperdrejte në prokurimin e qendrueshëm duke optimizuar shpenzimet me anë të shpërndarjes së ushqimeve për kategori sociale në pamundësi.

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

a. Cilesia e planveprimit në aspektin mjedisor: 0- 5 pike

b. Cilesia e planveprimit në aspektin social: 0-5 pike

**Vlerësimi me pike do të bëhet duke analizuar përfshirjen e elementeve të argumentimit duke mos u kufizuar në to. Me 0 pike do të vlerësohen operatorët ekonomikë të cilët nuk paraqesin fare planveprim ose një planveprim që nuk përmban asnjë të dhënë të përshkruar në argumentim. Ndërsa pikëzimi 1-5 pike do të bëhet duke u bazuar në cilësinë dhe përshkrimin e elementeve të argumentimit.*

3. Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm – [0-10] pikë

Argumentim: Ofertuesi duhet të zbatojë një plan për reduktimin e ambalazheve të panevojshme dhe përdorimin e paketimit të qëndrueshëm.

Ky plan duhet të përfshijë (por pa u kufizuar në):

- përpilimin e inventarit të mbetjeve: duke analizuar të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve të tjera (përveç mbetjeve ushqimore);*
- reduktimin e mbetjeve në blerjen e lëndëve të para, me të cilat do të përgatiten racionet (dietat): zgjedhja e llojit të duhur të paketimit për të reduktuar mbetjet (p.sh. paketim të ripërdorshëm), paketim të riciklueshëm dhe kthimi i paketimit për ripërdorim vetëm në raste kur kjo është e mundur dhe nuk çënon sigurinë e ushqimit;*
- reduktimin e mbetjeve në shërbimin e kateringut: shmangia e artikujve me ambalazh dytësor të panevojshëm ose të tepërt, përdorimi i kontenitorëve që mund të rimbushen (për erëza), etj.*

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

Në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimit të politikave të prokurimit të gjelbër, zgjedhja e llojit të duhur të paketimit gjatë blerjes së produkteve ushqimore përbën një element kyç në reduktimin e mbetjeve dhe ndikimit negativ në mjedis.

Paketimi i thjeshtë, funksional dhe i biodegradueshëm ndihmon në:

- *Reduktimin e volumit të mbetjeve të ambalazhit, të cilat përndryshe përbëjnë një ngarkesë të konsiderueshme për mjedisin, zvogëlimin e përdorimit të materialeve plastike dhe ambalazheve dytësore (paketime të panevojshme brenda paketimeve), të cilat janë shpesh jo të riciklueshme dhe pa funksion real ruajtës;*
- *Sigurimin e ruajtjes më të mirë të produkteve ushqimore, duke garantuar jetëgjatësi më të madhe, kontroll cilësor dhe mbrojtje ndaj ndotjes apo dëmtimeve gjatë transportit dhe shpërndarjes;*

Vlerësimi do të behet si me poshte:

c. Plani i veprimit për ambalazhimin e panevojshëm dhe metodologjia e mbledhjes dhe perpunimit të këtij ambalazhi 0-5 pike

**Vlerësimi me pike do të behet duke analizuar përfshirjen e elementeve të argumentimit duke mos u kufizuar në to. Me 0 pike do të vlerësohen operatorët ekonomikë të cilët nuk paraqesin fare planveprim ose një planveprim që nuk përmban asnjë të dhënë të pershkrueshme në argumentim. Ndërsa pikezimi 1-5 pike do të behet duke u bazuar në cilësinë dhe pershkrimin të elementeve të argumentimit.*

d. Lloji i paketimit i zgjedhur i cili mund të jetë i biodegradueshëm ose i riciklueshëm 5 pike. Nëse për këtë kriter nuk paraqitet asnjë dokument, ose asnjë dokument që të vërtetojë se paketimi i propozuar nuk ka elemente pro mjedisore vlerësohet me 0 pike.

- *Ky kriter do të vlerësohet bazuar në dokumentacion faktik siç është një marrëdhënie e dëshmuar me një prodhues apo distributor të paketimeve ushqimore. Në marrëdhënie është me distributor të autorizuar do të vërtetohet marrëdhënia e distributorit me prodhuesin. Në aktet provuese duhet të pershkruset natyra e paketimit nëse është e riciklueshme, e biodegradueshme apo e ndonjë lloji tjetër, miqësore me mjedisin.*

4. Transporti ekologjik [0-10 pike]

Argumentim: Ofertuesi duhet të dëshmojë se shërbimi i transportit të ushqimit deri në ambientet e AK, do të realizohet me mjete transporti me emetime të ulëta, si më poshtë:

- përdorimin e mjeteve të transportit frigoriferik të llojit elektrik ose hybrid ose çdo lloj tjetër automjeti transporti i cili ka emetimin me të ulet të CO₂ të provuar me dokumentacion.

Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për spitalet është një proces i përditshëm, me frekuencë të lartë shpërndarje, përdorim të mjeteve transportuese dhe konsum të konsiderueshëm paketimi dhe energjie, duke sjellë ndikime direkte në mjedis.

Kërkesa për përdorimin e mjeteve frigoriferike elektrike/ hibride dhe me pak emetime kontribuon jo vetëm në uljen e ndotjes në mjedisin ku këta mjete qarkullojnë, por edhe në zvogëlimin e ndotjes globale dhe përmbushjen e objektivave të klimës. Automjeti i propozuar do të levizte minimalisht tre here në ditë për shpërndarjen ushqimore, kështu që frekuenca e levizjes dhe ndotja është relativisht e lartë. Për këtë arsye, automjetet me emetime të uleta janë me miqësore me mjedisin.

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë, dokumentacionin e kërkuar në pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si dhe:

- certifikatë të regjistrimit të mjetit me të dhënat teknike (viti, lloji, standarti EURO)*

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

- Nëse OE disponon një automjet elektrik vlerësohet me 10 pikë, nëse disponon një mjet hybrid vlerësohet me 5 pikë dhe nëse disponon automjet tjetër me emetim të ulët vlerësohet nga 0 (nëse emetimi është i lartë) deri në 4 pikë.***

III.2.2. Në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, LOTI 1 “Gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Catering) në S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi, ku ndër të tjera ka përcaktuar si më poshtë:

LOTI 1 “Shërbim Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi (Catering)” në S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë”

Objektivi kryesor:

Siguria e shërbimit të vazhdueshëm të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, për të mbajtur një nivel të lartë higjienë, për të parandaluar infeksionet dhe për të siguruar kushte optimale për trajtimin e pacientëve. Kjo është e domosdoshme për të ofruar një shërbim të sigurt dhe të shëndetshëm për pacientët dhe stafin, duke u siguruar që çdo fazë e shërbimit të përmbushë standartet e kërkuara dhe të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së kujdesit mjekësor.

Shërbimet 24 Orë në 7 ditë:

Ky shërbim është i domosdoshëm të zhvillohet në një format që siguron furnizimin e ushqimit 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik

"Mbretresha Geraldinë" ofron shërbime të vazhdueshme për pacientët, duke përfshirë repartet e urgjencës, lindjes, repartet e kirurgjisë dhe ata që janë në kujdes intensiv, si dhe shërbime të tjera ku nevojat ushqimore janë specifike dhe kërkojnë përkujdesje të veçantë. Ushqimi duhet të jetë i gatshëm në çdo moment të ditës dhe natës për të siguruar ushqim të përshtatshëm për pacientët në kushte emergjente apo në kushte të tjera specifike të nevojave mjekësore.

Rëndësia për Pacientët:

Shërbimi i ushqimit në spital duhet të ofrojë një dietë të ekuilibruar dhe të pasur me lëndët ushqyese që mbështesin rikuperimin dhe përmirësimin e shëndetit të pacientëve, duke marrë parasysh nevojat e veçanta të çdo pacienti, përfshirë dietat speciale për pacientët që vuajnë nga sëmundje të veçanta, si diabeti, hipertensioni, alergjitë ushqimore, etj. Ushqimi duhet të jetë i përgatitur dhe shpërndarë në mënyrë që të ruhet siguria ushqimore dhe të përputhet me standardet e higjienës dhe sigurisë shëndetësore.

Rëndësia për Stafin Mjekësor:

Ushqimi është gjithashtu i rëndësishëm për stafin mjekësor, i cili duhet të ketë mundësi të ushqehet gjatë gjithë ditës dhe natës, veçanërisht për ata që janë në turne të gjatë. Ushqimi duhet të jetë i përshtatshëm, i shpejtë dhe i shëndetshëm për të siguruar që stafi të ketë energjinë dhe përqendrimin e nevojshëm për të ofruar kujdes mjekësor të mirë.

Rëndësia për Higjienën dhe Sigurinë Ushqimore:

Sigurimi i një shërbimi të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit që plotëson kërkesat më të larta të higjienës dhe sigurisë ushqimore është një prioritet i jashtëzakonshëm për spitalin. Ushqimi duhet të përgatitet dhe të shpërndahet në kushte të rrepta higjienë për të parandaluar çdo mundësi infeksioni, duke respektuar standardet ndërkombëtare dhe rregulloret lokale të sigurisë ushqimore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një spital, ku pacientët janë të dobësuar dhe më të ndjeshëm ndaj infeksioneve.

Përshtatshmëria për Shërbime të Ndryshme Spitalore:

Spitali ofron një gamë të gjerë shërbimesh mjekësore dhe kirurgjikale, duke përfshirë operacione të ndërlikuara dhe trajtime të veçanta për pacientët.

Ushqimi duhet të jetë i përshtatshëm për lloje të ndryshme pacientësh, duke përfshirë gratë shtatzëna, pacientët post-operatorë dhe ata që janë në terapinë intensive. Dietat duhet të respektojnë kërkesat mjekësore për çdo pacient dhe të sigurojnë që çdo ushqim të jetë i përshtatshëm për gjendjen e shëndetit të individëve.

Dietat janë si më poshtë vijon:

1. DIETA NR. 1: "DIETA NORMALE"

2. **DIETA NR. 2: HIDRIKE B1 “POST INTERVENTE”**
3. **DIETA NR. 10: “PA GLUTEN”**
4. **DIETA NR. 12: “DIABETIKE”**
5. **DIETA NR. 13: “HIPONATRIKE”**
6. **DIETA NR. 14: “ONKOLOGJIKE”**

- **Dieta Nr. 1: “DIETA NORMALE”, ka këta elementë në përbërje të tij:**

Nr	Emërtimi	Njësi a	Kalorazhi	Përdorimi
A	ADULT	dieta	2773 kkal (prot 100g, lipide 77g, glucide 420g)	Për të sëmurë me aparat tretës normal
	Dieta Nr.1 (Normale)			

Ndërkohë, elementët përbërës të kësaj diete janë specifikuar më në detaje të urdhërit të MSHMS – së si më poshtë vijon:

DIETA PËR TË RRITUR:

Dieta Nr.1

Nr.	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht	ml	300
2	Sheqer	gr	15
3	Buke	gr	250
4	Oriz/makarona	gr	150
5	Zarzavate	gr	500
6	Vaj	ml	30
7	Mish	gr	150
8	Fruta	gr	300

9	Djathe, gjize	gr	80
10	Gjalp	gr	10

- **Arsyetimi i përzgjedhjes së kësaj diete:**

Dieta e mësipërme është një ndër dietat që paraqet vlera ushqyese, është e përshtatshme për të gjithë pacientët me parametra normal të shëndetit. Kjo dietë është një dietë e balancuar me kalori dhe vlera ushqyese të duhura për pacientët me shëndet normal.

Gjithashtu, është lloji i dietës që do të jetë më i nevojshmi për t'u aplikuar në S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë”.

Ky ushqim përfshin një balancë të mirë mes proteinave, yndyrnave dhe karbohidrateve, të cilat janë të nevojshme për shëndetin e përgjithshëm të pacientëve.

Padiskutim që edhe lloji i pacientëve që paraqesin komplikacione të shëndetit/patologji të ndryshme janë të konsiderueshme, e për këtë arsye, lloji i menuve që do të paraqesim më poshtë si të përzgjedhur nga ana jonë, i referohet këtyre kategorive të tjera të pacientëve, që edhe pse më të ulëta në numër, kanë nevojë për trajtim specifik ushqimor.

Dieta Nr. 2: Hidrike B1 “POST INTERVENTE” ka këta elementë në përbërje të tij:

DIETA PËR TË RRITUR:

Nr	Emërtimi	Njësi a	Kalorazhi	Përdorimi
A	ADULT	dieta	= 400 kkal, (prot. 0 gr., lipide 0 gr., glucide 100 gr.)	Përdoret pas interventeve kirurgjikale në abdomen dhe në sindromën abdominal akute.
3	Dieta Nr.2 (Hidrike B1)			

Ndërkohë, elementët përbërës të kësaj diete janë specifikuar më në detaje të urdhërit të MSHMS – së si më poshtë vijon:

DIETA PËR TË RRITUR:

Nr.	Asortimenti	Nj.m	Sasia
-----	-------------	------	-------

1	Lëng frutash	gr	1000
2	Sheqer	gr	100

- **Arsvetimi i përzgjedhjes së kësaj diete:**

Dieta e mësipërme është e rekomanduar për pacientët pas intervenimeve kirurgjikale dhe hyn tek dietat me kalori të ulëta dhe pa proteina, yndyrna dhe karbohidrate, duke mundësuar rikuperimin e pacientëve që kanë kaluar operacione kirurgjikale.

Kjo dietë është e rëndësishme, pasi pas operacioneve të tilla, pacientët kanë nevojë për lëngje dhe kalori për të ruajtur ekuilibrin elektrolitik dhe të hidratimin e trupit, pa i ngarkuar ato me substanca të rënda për tretje.

- **Dieta Nr. 10: “PA GLUTEN” ka këta elementë në përbërje të tij:**

DIETA PËR TË RRITUR:

Nr	Emërtimi	Njësi a	Kalorazhi	Përdorimi
A	ADULT	Dieta	= 2764 kkal (prot. 100 gr., lip. 78.5 gr., gluc. 385.5 gr)	Dieta pa gluten
13	Dieta Nr.10			

Ndërkohë. elementët përbërës të kësaj diete janë specifikuar më në detaje të urdhërit të MSHMS – së si më poshtë vijon:

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	550
2	Sheqer	gr	20 20
3	Djathe	gr	50
4	Veze	gr	15 1
5	Gjalpe	gr	15

6	Vaj	gr	15
7	Zarzavate	gr	550
8	Mish	gr	200
9	Oriz	gr	150
10	Fruta	gr	400
11	Buke misri	gr	200

- **Arsyetimi i përzgjedhjes së kësaj diete:**

Dieta e mësipërme pa gluten, është një dietë e veçantë për pacientët që vuajnë nga intoleranca ndaj glutenit.

Kjo dietë është shumë e rëndësishme për ruajtjen e shëndetit të këtyre pacientëve, pasi gluteni mund të shkaktojë inflamacion të zorrëve dhe përkeqësim të shëndetit të pacientëve të tillë.

Ky plan ushqimor është i balancuar dhe ofron kalori dhe vlera ushqyese të nevojshme për pacientët që ndjekin një regjim të tillë ushqimor.

- **Dieta Nr. 12: “DIABETIKE” ka këta elementë në përbërje të tij:**

DIETA PËR TË RRITUR:

Nr	Emërtimi	Njësi a	Kalorazhi	Përdorimi
A	ADULT	Dieta	Kjo dietë varion nga 800-3000 kkal, diapazone që përfshin diabetiko – obezë dhe ata të dobët.	
14	Dieta Nr.12			

Ndërkohë. elementët përbërës të kësaj diete janë specifikuar më në detaje të urdhërit të MSHMS – së si më poshtë vijon:

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht, kos	ml	600
2	Buke	gr	150
3	Zarzavate	gr	500
4	Veze	koker	1
5	Djathe	gr	50
6	Gjalpe	gr	20
7	Oriz	gr	100

- **Arsyetimi i përzgjedhjes së kësaj diete:**

Dieta e mësipërme e quajtur dieta diabetike është e përshtatshme për pacientët me diabet, pasi ajo ndihmon në kontrollin e niveleve të sheqerit në gjak.

Kjo dietë është veçanërisht e rëndësishme për pacientët që kanë nevojë për një menaxhim të kujdesshëm të konsumit të karbohidrateve dhe yndyrnave, duke i ofruar atyre mundësinë për të ruajtur nivelet e sheqerit të qëndrueshme.

Dieta përfshin ushqime që janë të pasura me fibra dhe proteina, duke ndihmuar pacientët të menaxhojnë sëmundjen e tyre dhe të mbajnë peshën trupore nën kontroll.

Dieta Nr. 13: “HIPONATRIKE” ka këta elementë në përbërje të tij:

Nr	Emërtimi	Njësi a	Kalorazhi	Përdorimi
A	ADULT	Dieta	= 2280 kkal (prot., 90 gr., lip., 64 gr., gluc. 336 gr)	(Dieta normokalorike shumë e varfër në Na) Përdoret në sëmundjet ap. Kardiovaskulare dhe urinare në fazën e kompensimit në sëmundjen e mëlcisë, pankreasit e surenaleve. Përdorimi i kripës nuk duhet bërë i lirë kur nisin shenjat e
16	Dieta Nr.13			

				dekompozimit. Kur azotermia e kratinemia, kur produktet si; mishi, qumështi dhe nënproduktet ndërpriten, në dietë shtohen frutat deri në 150 gr.
--	--	--	--	--

Ndërkohë. elementët përbërës të kësaj diete janë specifikuar më në detaje të urdhërit të MSHMS – së si më poshtë vijon:

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	200
2	Mish	gr	100
3	Veze	kokerr	1
4	Gjize	gr	50
5	Vaj	ml	30
6	Gjalpe	gr	10
7	Zarzavate	gr	400
8	Fruta	gr	350
9	Buke pa kripe	gr	160
10	Oriz	gr	130

130

- **Arsvetimi i përzgjedhjes së kësaj diete:**

Dieta e quajtur Dieta hiponatrike, është e nevojshme për pacientët që vuajnë nga sëmundje të sistemit kardiovaskular dhe të urinar, si dhe për pacientët me sëmundje të mëlçisë dhe pankreasit. Kjo dietë është shumë e rëndësishme për ata që kanë nevojë për një mbështetje të fortë në kompensimin e niveleve të ulëta të natriumit në trup, si dhe për parandalimin e edemave dhe mbajtjes së ujit në trup.

Ky regjim ushqimor ofron një përmbajtje të lartë të frutave dhe perimeve, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e ekuilibrit elektrolitik.

Gjithashtu, është dieta më e përshtatshme për pacientet shtatëzëna me PE (Preklampsi) dhe kanë nevojë për një dietë të varfër me natrium, me qëllim parandalimin e çdo komplikacioni të mundshëm.

Dieta Nr. 14: “ONKOLOGJIKE” ka këta elementë në përbërje të tij:

DIETA PËR TË RRITUR:

Nr	Emërtimi	Njësia	Kalorazhi	Përdorimi
A	ADULT	Dieta	3000 kkal, (prot. 122 gr., lip. 108 gr., gluc. 385 gr)	(Onkologe) Hiperkalorie, hiperproteinike, hiperglucidike e pasur me Ca e Fe. Kjo diete përdoret në anemi, kaheksi, TBC, sëmundje malinje, otopedi, plastike, rehabilitim, sëmundje psikike.

Ndërkohë elementët përbërës të kësaj diete janë specifikuar më në detaje të urdhërit të MSHMS – së si më poshtë vijon:

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/ kos	ml	600
2	Mish	gr	200
3	Vaj	ml	30
4	Gjalpe	gr	15
5	Djadhe/gjize	gr	100
6	Veze	kokërr	1
7	Sheqer	gr	30

8	Oriz	gr	110
9	Zarzavate	gr	500
10	Fruta	gr	400
11	Buke	gr	300

- **Arsvetimi i përzgjedhjes së kësaj diete:**

Dieta e mësipërme, e quajtur Dieta Onkologjike, është një dietë me kalori të larta dhe me proteina të larta, të nevojshme për pacientët që janë duke u trajtuar për sëmundje malinje. Duke pasur një përmbajtje të lartë të kaloriave dhe proteinave, dieta onkologjike ndihmon në forcimin e trupit dhe përmirësimin e statusit imunitar.

Dieta është një aspekt thelbësor i trajtimit dhe rehabilitimit të pacientëve të shtruar në S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë”.

Sigurimi i një diete të përshtatshme për çdo pacient është një element kyç në përmirësimin e shëndetit të tyre dhe rikuperimin e shpejtë dhe dietat e mësipërme janë përzgjedhur, me qëllim që të sigurojnë një mbështetje të plotë ushqimore për pacientët, duke u përshtatur me nevojat e veçanta të grupeve të ndryshme të pacientëve.

DIETA NORMALE (PER MJEKE)						
Rreth 3000 kilo/kalori						
Proteina 111,2 Yndyrna 97,4 Kkarbohidrate 414,5						
Asortimenti	Njesia mates e	Sasia	K/Kalori	Proteina	Yndyrna	Karbohidrate
Qumesht/kos	ml	400	244,0	12,4	13,6	19,2
Mish vici	gr	200	320,0	38,2	18,6	-
Vaj	gr	30	270,0	-	30,0	-
Gjalpe	gr	10	75,8	0,1	5,2	0,1
Djathe	gr	80	247,2	9,0	21,5	4,8
Veze	koker	1	78,0	7,3	6,2	0,6
Sheqer	gr	30	117,6	-	-	30,0
Oriz-Makarona	gr					

		110	233,8	10,5	1,7	85,4
Zarzavate	gr	500	155,0	9,2	1,0	25,0
Buke	gr	300	801,0	26,7	1,8	180,9
Fruta	gr	400	180,0	0,8	1,2	44,0
Recel-Marmalate	gr	50	111,0	0,3	-	29,4

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PRODUKTEVE QË DO TË PËRDOREN :

Lloji i mallit: Bukë gruri rreze 75 %

1. Buka e grurit do të prodhohet me miell rreze 75 %, i stazhinuar për një periudhë prej 10-30 ditësh. Mielli duhet të jetë i freskët, me ngjyrë, erë, shije dhe lagështirë konform standarteve përkatëse të miellit me rreze 75 %. Mielli nuk duhet të ketë asnjë lloj lënde të huaj.
2. Buka duhet të ketë formë të drejtë dhe normale, pa deformime dhe sipërfaqja e bukes duhet të jetë e lëmuar dhe pa plasje të ndryshme. Vëllimi i bukës duhet të jetë i mjaftueshëm. Shija, era, lagështira dhe aciditeti i bukës duhet të jetë konform standartit teknik të prodhimit të saj.
 - Korja e bukës – duhet të jetë e lëmuar, pa djegie, pa shpëputje të saj nga tulli, ngjyra e njëllojtë, mjalti në të kuqërremtë, në të gjithë sipërfaqen.
 - Tulli duhet të jetë i pjekur mirë, me porozitet të imët në të gjithë vëllimin e tij dhe nuk duhet të ketë gjurmë mielli të pabrumosura.
3. Nuk pranohet buke e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me erë të huaj, me shije të hidhur e të thartë, me lënde të huaja, me lagështirë jo normale, me shije myku.
4. Treguesit fiziko – kimik:
 - Buka preferohet në formë kateërkëndëshe dhe me peshë 1(një) kg, lagështira jo më shumë se 45 %, poroziteti jo më pak se 70%, aciditeti jo më shumë se 4.5.
5. Buka duhet të jetë e prerë në feta dhe e ambalazhuar në qese plasmasi.

Lloji i mallit: Bukë Misri.

1. Bukë e prodhuar kryesisht me miell misri, e pjekur në mënyrë tradicionale ose industriale, me ose pa përzierje të miellit të grurit, e destinuar për konsum ushqimor.
2. Përbërësit (për 1 kg produkt final):
 - Miell misri: 70–100%
 - Miell gruri (opsional): 0–30%.
 - Ujë: sipas nevojës teknologjike.
 - Kripë: 1.5–2% të masës së thatë.
 - Majë buke ose pluhur pjekës (opsional).
3. Vlerat ushqyese mesatare (për 100g produkt):
 - Energjia: ~230–270 kcal

- Proteina: 5–7 g
- Karbohidrate: 50–60 g
- Yndyrna: 2–4 g
- Fibrat dietike: 4–6 g
- Kripë: ≤ 1 g

4. Karakteristikat organoleptike:

- Pamja: Formë tradicionale ose industriale, sipërfaqe e fortë dhe ngjyrë e verdhë karakteristike.
- Aroma: E lehtë, e këndshme, tipike e misrit.
- Shija: E butë, karakteristike e misrit, pa shije të huaj.
- Struktura: E fortë nga jashtë, por jo e thatë; e thërrmueshme nga brenda.

5. Parametrat Fiziko-Kimikë:

- Lagështia maksimale: $\leq 38\%$
- pH: 5.0 – 6.0
- Afat përdorimi: 2–3 ditë në kushte ambienti, deri në 7 ditë në frigorifer.

6. Kriteret Mikrobiologjike (në përputhje me standardet kombëtare dhe të BE-së):

- E. Coli: Jo i pranishëm në 1g
- Salmonella: Jo i pranishëm në 25g
- Myk dhe maja: ≤ 100 CFU/g

Lloji i mallit: **Gjalp lope.**

Pamja: E njëtrajtshme pa shtresa në prerje me sipërfaqe të shndritur pa pika uji dhe mbeturina dhalli.

Ngjyra:

- Gjalpi i freskët ngjyra krem deri në të verdhë të çelur
- Gjalp i kripur ngjyra e bardhë deri në të verdhë, karakteristike e kremës nga e cila prodhohet e njëllotë në të gjithë masën.

Konsistenca në temperaturën 10 – 12 °C, gjysëm e fortë.

Era dhe shija :

- Gjalpi i freskët, e këndshme, karakteristike e gjalpit të freskët ,pa erë dhe shije të huaj.
- Gjalp i kripur,era e këndshme, karakteristike e gjalpit, lehtësisht e kripur, pa erë dhe shije të huaj.

Treguesit fiziko kimikë:

1- Lagështira në % , jo më shumë se 17 %.

2- Lëndë e thatë pa yndyrë në %, jo me shume se 2 %.

3- Yndyra në %, jo më pak se 81 %, gjalpi i freskët dhe 79 % gjalpi i kripur.

4- Kripë në % jo më shumë se 2% gjalpi i kripur.

5- Aciditeti i shprehur në g/Ketshtofer jo më shumë se 3 gjalpi i freskët dhe 5 gjalpi i kripur.

6- Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Lloji i mallit: **Djathë i bardhë lope.**

Lloji: Djathë i Bardhë gjysëm i fortë cilësia e parë.

Pamja e jashtme: E pastër dhe pa të meta në sipërfaqe, në prerje duken sytha teknike.

Era dhe shija: Të ketë erë dhe shije të këndshme karakteristike e djathit të stazhionuar, pa shije të hidhur dhe aromë të huaj.

Forma dhe masa: Formë sektori, kubi, paralelopipedi. Masa 3-4 kg

Konsistenca: E lëmuar jo e fortë dhe pa dallim shtresash. Të mos thërmohet gjatë prerjes në racione të vogla deri 40 gr.

Ngjyra: E bardhë në krem.

Treguesit Fiziko – Kimik:

-Lëndë e thatë jo më shumë se 48 %.

-Yndyra në lëndë të thatë jo më shumë se 50%.

-Kripe jo më shumë se 4%.

-Ngarkesa mikrobike Brenda kufijve të lejuar nga (ISHP).

-Lagështia jo më shumë se 56 %.

Ambalazhimi: Të jetë i ambalazhuar në voza deri 20 kg të zhytur tërësisht në shëllirë me përmbajtje 10-14% Kripe. Në ambalazhim të shënohen emri prodhuesit, emërtimi produktit, masa neto, data e prodhimit, data e skadencës.

Lloji i mallit: **Qumësht lope.**

Të jetë qumësht lope i cilësisë së parë me 2+ - 0.1% yndyrë. Qumështi duhet të jetë me ngjyrë të bardhë dhe erë karakteristike, i freskët. Qumështi të jetë i pasterizuar dhe sterilizuar. 12 % lëndë të thatë dhe aciditet 21%.

Lloji i mallit: **Kos lope.**

Stazh 1443-87 i përgatitur nga qumësht i freskët lope i pasterizuar, i homgjenezuar, skremuar.

Lloji: Të jetë i freskët, cilsia e parë.

Ngjyra: E bardhë.

Era dhe Shija: E këndshme, karakteristike e kosit.

Pamja e jashtme: Homogjene në të gjithë sasinë e lëngut:

Treguesit Fiziko – Kimik:

-Proteinë 3.2 gr

-Yndyrë 2-3.0 %

-Karbohidrate 4.7 gr

-Kalori 248kal/59kcal

Lloji i mallit: **Mish viçi i freskët.**

Lloji: Mish viçi i freskët cilësia e parë.

Kërkesat cilësore:

Pamja e jashtme: sipërfaqja e mishit është e mbuluar me një cipë të hollë të thatë. Sipërfaqja e mishit pas prerjes është e lagur dhe e ndritshme, lëngu del me vështirësi dhe është i tejkuqshëm. Tendinat janë të shndritshme elastike dhe të forta.

Ngjyra: Mish i viçit ka ngjyrë rozë e ndryshme nga lopa që ka ngjyrë të kuqe dhe kau me ngjyre të kuqe të mbyllur. Në prerje sipërfaqja është e ndritshme, ngjyra e dhjamit është e bardhë tek kafshët e reja ndërsa tek kafshët e rritura është e verdhë.

Era: e këndshme, karakteristike e llojit.

Palca e kockave: Mbush plotësisht kanalën e palcës së kockave.

Ngjyra është rozë e verdhë.

Në prerje është e ndritshme.

Lëngu i mishit pas zierjes: i tejdukshëm aromatik, në sipërfaqe duket shtresa ose pika yndyre.

Treguesit kimiko mikrobik:

1. Azot i tretshëm, në mg, Amonjiak (NH₃) për 100gr produkt jo më shumë se 20.

2. Aciditeti i shprehur në pH 5.2 deri në 6.4.

3. Reaksioni për hidrogjenin sulfuror negativ.

4. Ngarkesa mikrobike brenda normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Treguesit kimik e mikrobik analizohen vetëm në ato raste kur dyshohet për ndryshimet që ka pësuar mishi.

Mishi i viçit trajtohet në gjysma trupi e në çerek. Trupi ndahet në mes të vertebrave kur ndahet në gjysëm, ndërsa ndarja në çerek bëhet ndërmjet brinjës 12 e 13. Koka veçohet nga trupi në vertebrën e parë, këmbët tek kupa e gjurit, organet e brendshme veçohen përveç veshkave. Mishi i viçit përpara se të serviret të jetë i zhveshur nga kockat.

Çdo parti/karkasë mishi shoqërohet me certifikatë veterinare, e cila garanton sigurinë e produktit “mish” dhe më të cilën vërtetohet se nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje, por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik. Vula e raportit veterinar të jetë e lexueshme mirë dhe çdo pjesë e karkasës (shpatull, kofshë dhe gjoks) duhet të jetë e vulosur me vulën e kontrollit veterinar. Transporti i mishit brenda rrethit bëhet me mjete të mbyllura të pastra e të dezinfektuara posaçërisht për mishin me aparat matës temperaturë (taograf). Kërkohet cilësia e parë sipas standartit dhe vetëm kofshët e pasme.

Lloji i mallit: **Sallam (Salçiçe).**

Me përberje mish lope, vici ose pule, i paketuar në pako treshe celefone, nga 250 gr secila i freskët dhe i pajisur me certifikatën sanitare, të mos përmbajë shumë yndyre dhe furnizimi të bëhet me mjete frigoriferike. Mishi të jetë ngjyrë rozë dhe të ketë erë të këndshme. Malli të jetë i shoqëruar me certifikatë cilësie me të gjithë parametrat.

Lloji i mallit: **Oriz i zhveshur cilësia e parë.**

Specifikimet teknike:

1. Pamja e jashtme: Kokrra të shëndosha, të pastra .të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shenja myku ose prishje.
2. Ngjyra: E bardhë.
3. Era dhe shija: Karakteristike e orizit të shëndoshë, pa shije të thartë, të hidhur, pa erë myku dhe erë tjetër të huaj.

Treguesit fiziko kimikë:

1- Lagështira në % jo më shumë se 15 (për efekte ruajtje)

2- Lëndë të huaja (mel, farna të barërave të këqija, byk kashte, kokrra boshe,etj % jo më shumë se 0.2.

3-Kokrra jeshile të pazhvilluara në % jo më shumë se 0.3.

4-Kokrra të thyera më të vogla se gjysma në % jo me shumë se 12.

5-Kokrra të kuqe në % jo më shumë se 5.

6-Kokrra të verdha në % jo më shumë se 2.

Lloji i mallit: **Makarona.**

Specifikimet teknike:

Ngjyra : E bardhë me nuancë të verdhë. Në thyerje paraqiten qelqore në jo më pak se gjysmën e sipërfaqes së seksionit.

Era dhe shija: E mire, karakteristike e makaronave, pa shije të hidhur të tharte të mykur dhe pa erë tjetër të huaj.

Pas zierjes ka ere të kendshme.

Treguesit fiziko kimikë:

1-Lagështira në % jo më shumë 13 (për efekte ruajtje)

2-Aciditeti në % acid sulfurik jo më shumë se 0.16.

3-Rritja e vëllimit mbas zierjes jo më pak se dy herë.

4-Insekte dhe dëmtues të tjere nuk lejohen.

Lloji i mallit: **Vaj.**

Specifikimet teknike:

1. Pamja e jashtme: Në gradë Celsius, lëng vajor I qartë pa depozitime.

2. Ngjyra: E verdhë e lehtë.

3. Era dhe shija: Karakteristike e vajit të lulediellit, e mirë, pashije dhe pa erë të huaj.

Treguesit fiziko kimikë:

1- Aciditeti i shprehur në acid oleic jo më shumë se 0.2 g\100g vaj.

2- Masa specifike në 20 gradë Celsius 0,918-0,923.

3- Lageshtira dhe lëndët fluturuese në 105 °C %, jo më shumë se 0,2.

4- Numri i sapunifikimit në mg KOH\g vaj 188-194.

5- Numri i jodit sipas Hanusit 118-141.

6- Lëndët e ptrethshme në eter ose benzol, në %, jo më shumë se 0.05.

7- Përmbajtja e sapunve në %, jo me shumë se 0.005.

8- Lëndët e pasapunifikueshme në jo më shumë se 15g\kg.

9- Numri i peroksive jo më shumë se 10 mek O₂ aktiv\kg vaj.

10- Treguesit e refraksionit 1,461-1,468.

11- Përmbajtja e mikroelementve ,mg\kg vaj jo më shumë se:

❖ Hekur 1,5

❖ Bakër 0,1

❖ Plumb 0,1

❖ Arsenik 0,1

Lloji i mallit: **Vaj Ulliri; S SH 1402-2004 ose ekuivalent.**

Treguesit organo leptike: Pamja e jashtme të jetë e kthjellët dhe pa asnjë turbullire.

Ngjyra të jetë e verdhë deri në lehtësisht jeshile. – Era dhe shija karakteristike të vajit të ullirit.

Nuk duhet të përmbajë lëndë të huaja, të jetë i rafinuar, aciditeti nuk duhet të kalojë 0.5 %.

Amballazhimi ne shishe 0.5-1 litërsh qelqi ose plastike transparente me etiketë ku të shënohen standardet.

Nuk duhet të jetë i perzier me vajra të tjerë dhe konservantë.

Treguesit e tjerë fiziko kimik sipas SSH.

Markërimi:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit.

Pesha neto ose vëllimi i produktit.

Data e prodhimit.

Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

Lloji i mallit: **Kripë e jodizuar**

Bazuar, në, SSH 1437/2005

Lloji: Kripë ushqimore përpunuar dhe bluar për përdorim në kuzhinë.

Pamja: Masë kokrrizore

Ngjyra: E bardhë

Era dhe shija : E kripur pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit fiziko kimikë:

1. Imtësia në mm 0.2 – 2
2. Klorur Në lëndën e thatë ne %, jo me pak se 98
3. Klorur Mg në lëndën e thatë ne %, jo me shumë se 0.3
4. Sulfat Mg në lëndën e thatë ne %, jo me shumë se 0.9
5. Sulfat Ca në lëndën e thatë ne %, jo me shumë se 0.2
6. Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në %, jo me shumë se 0.3
7. Lageshtirë në %, jo me shumë se 1
8. Jodur kaliumi mg/kg 50 + - 3

Kripa të plotësojë të gjithë kërkesat higjieno shëndetësore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Amballazhimi: Të bëhet në qese të paster ose polietileni ushqimorë, opak me masë 1 – 25 kg.

Markërimi:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale)
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Lloji i mallit: **Erëza.**

Erëzat të jenë cilësia e parë, e paketuar në pako të vogla, e pastruar nga barishte dhe papastërtitë, tharë në kushte të mira, me erën karakteristike sipas llojit.

Lloji i mallit: **Majdanoz.**

Të jetë i cilësisë së parë, i pastruar nga barishtet dhe papastërtitë, të ketë erë karakteristike.

Lloji i mallit: **Koper.**

Të jetë i cilësisë së parë, i pastruar nga barishtet dhe papastërtitë, të ketë erë karakteristike.

Lloji i mallit: **Miell gruri.**

Treguesit shqisor:

Ngjyra: E bardhë me nuancë të lehtë në të verdhë në varësi të llojit të grurit.

Pjesëzat e himeve janë të padukshme me rreze 80 %.

Era dhe shija: Karakteristikë e miellit të grurit, pa erë myku, pa shije të hidhur e të thartë dhe pa erë e shije të huaj. Nuk lejohen kërcitje.

Treguesit fizikë dhe kimikë:

Lageshtira, %, jo më shumë se 14

Aciditeti i shprehur në acid sulfurik në lëndët absolutisht të thata %, jo më shumë se 0.115

Hiri i tretshëm, në lëndën absolutisht të thatë %, jo më shumë se 0.9

Hiri i patretshëm në acid klorhidrik 10%; në lëndën absolutisht të thatë %, jo më shumë se 0.1

Mbisitja (imtësia e bluarjes):Për miellrat e bluar në fabrikat me cilindra:

Në sitën metalike nr.54,%, jo më shumë se 2

Në sitën e mëndafshtë 5 xxx,%, jo më shumë se 5

Gluteni i njomë, %, jo më pak se 25

Lënde minerale, nuk lejohen

Perzierje metalike. Plumbi, zinku e bakri, nuk lejohen

Lejohet permbajtja e hekurit në formë thërmijash nën 0.3 mm, jo më shumë se 3mg.g

Mikroorganizma patogjene, infestime dhe dëmtues hambari të gjallë, nuk lejohen

Lloji i mallit: **Reçel cilësia e I –rë**

1. Pamja e jashtme: Jo e shëndritshme, e pasheqerosur, me sipërfaqe të njëjlojtë, ku shënja myku dhe fermentimi nuk lejohen, pa pjesë të djegura, fara dhe pjesë të fermentuara.

2. Ngjyra: E njëjlojtë, karakteristike e frutave të përdorura të ziera me sheqer.

3. Shija dhe era: Me erë të pëlqyeshme, karakteristike e frutit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, e ëmbël pa shije karamalizimi e fermentimi, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

Treguesit kimik:

1. Lendë reduktuese (sheqer invert) jo me shume se 0,1%.

2. Lageshtia jo me shume se 0,16%.

3. Hiri jo me shume se 0,07%.

Amballazhimi:

-Të jetë i ambalazhuar hermetikisht në kavanoza qelqi apo plastike, me etiketë.

Lloji i mallit: **Salcë domate;**

Pamja e jashtme: Masë e njëllotë me konsistencë paste, jo fibroze pa fara, pa copa lëkure, pa pjesë të karamelizuara, të prishura ose të fermentura.

Ngjyra: E kuqe intensive karakteristikë e salcës së domates e njëllotë në të gjithë masën.

Era dhe shija: Karakteristike e domates pa shije dhe erë të huaj pa shije karamelizimi prishje ose fermentimi.

Treguesit fiziko kimikë:

Përmbajtja e ekstraktit të dobishëm sipas refraktometrit në % 28 –30

Aciditeti i Përgjithshëm në raport me ekstraktin i shprehur në acid acetic në % jo më shumë se 0.1.

Përmbajtja e sheqerit të përgjithshëm në % jo më shumë se 20.

Kripa të klorurit të na të vetë lëndës së parë në % jo më shumë se 1.3-2.

Përmbajtja e acidit sorbik në mg/kg jo më shumë se 600.

Përmbajtja e metaleve të rënda në mg /kg jo më shumë se

→ Zink 20

→ Kallaj 250

→ Plumb 0.4

→ Baker 30

→ Arsenik 0.4

Ngarkesa mikrobike: Brenda kufijve të lejuar nga Ministria e Shendetësisë.

Në salcën e domates nuk lejohen përmbajtje e lëndëve të huaja dhe përdorues artificial

Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raportë analize të laboratorit.

Lloji i mallit: **Vezë.**

1- Pamja e jashtme. E paster dhe pa plasje. Lejohen ndotje të lehta.

2- Dhoma e ajrit (lartesia), mm, jo më shumë se 9.

3- E bardha e vezës. E dendur e kulluar dhe e pastër pa njolla gjaku (të kontrolluar ne ovoskop).

4- E verdha e vezës. Kompakte e ndodhur në pozicionin qendror pak e lëvizshme. Lejohet devijim i vogël nga pozicioni qendror.

5- Era. Pa erë prishje dhe erë tjetër të huaj.

6- Masa në gr, jo më pak se 40.

Lloji i mallit: **Sheqer.**

1. Pamja e jashtme: pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëllotja. Pa copa sheqeri të ngjeshura ose lëndë të huaja. Të jetë i derdhur i thate në të prekur dhe të mos ngjitet.

Ngjyra : E bardhë dhe me shkëlqim.

Era dhe shija: Shije të ëmbël. Pa shije dhe ere të huaj.

Tretshmeria: Tretet plotësisht në ujë. Tretësira është e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

Treguesit fiziko kimikë:

1- Lagështira në % jo më shumë se 0.16(për efekte ruajtje)

2- Sheqer i pastër i llogaritur në lëndë absolutisht të thate në % jo më pak se 99.6.

3- Lëndë reduktuese (sheqer invert) në % jo më shumë se 0.1.

4- Hiri në % jo më shumë se 0.07.

5- Përzierje hekuri me madhësi deri në 0.3 mm, mg\1kg jo më shumë se 3.

6- Ngjyra sipas njësive shtamore (llogaritur në lëndë absolutisht të thatë) në% jo më shumë se 1.

Lloji i mallit: **Perime** (bamje, bizezele bishtajore, domate, patellxhan, qepë e njomë, qepë e thatë, spec, lakër, presh etj).

Bamja: Kërkohen të jenë të freskëta, të shëndosha, të pastra, me fije normale për kultivarin dhe fara që duket lehtë, me formë të drejtë, lehtësisht të deformuar. Forma të jetë e një prizmi shumëkëndësh që ngushtohet në majë, të pa drunjezuara e pa fije.

-Gjatësia e cilësisë së parë për bamjen frutshkurtër të jetë deri në 6 cm dhe për atë frutgjatë të jetë deri në 8 cm.

-Lejohet deri në 5 % të partisë me vyshkje të lehtë. Nuk lejohet me sëmundje e dëmtues.

-Ngjyra të jetë tipike për kultivarinë.

Domate: Kërkohet domate e cilësisë së parë, ku të jenë të freskëta, me forme tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pa vrara, të pa shtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga diegia e diellit, të pa prekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të pa lagura.

-Pjekuria duhet të jetë normale, me ngjyrë të kuqe, lehtësisht rozë dhe jeshile rreth bishtit.

-Nuk lejohen domate të tej pjekura, të zbutura e të vyshkura.

-Dëmtime e sëmundje nuk lejohen.

-Të plasura e të vrara lehtësisht për llojet e mesme e të vona lejohet deri në 5 % plasaritje rreth bishtit, por pa rrjedhje lëngu.

-Madhësia e kokrrës të jetë:

-Për të hershmet 3-4 cm

-Për të mesmet e të vonat 7 cm.

Patellxhan: kerkohet cilesia e pare, te jene te fresket, te paster, me siperfaqje te lemuar, me ngjyre te zeze ne manushaqe, me pjekuri normale, me flete jeshile me nuanca te dobeta manushaqe, te pa vyshkura.

-Demtime te ndryshme e semundje nuk lejohen.

-Per te gjatet kerkohet diametri jo me shume se 5 cm dhe gjatesia 15-20 cm.

-Gjatesia e bishtit te jete jo me shume se 4 cm.

Qepë e njomë: Kërkesë cilësore.

Pamja e jashtme: të njoma, të freskta, të pastra, të lara me uje të pijshëm, me ngjyrë jeshile të gjetheve, të pa çara, të pavyshkura dhe pa karabush.

Lejohet një karabush në tufë i pakëputur dhe jo me i gjatë se 5 cm.

Diametri i kercellit në cm mbi 1.5

Gjatesia e tufës në cm: pa kufizim në gjatësi dhe me bishta të paprerë.

Sistemi rrenjor në cm deri në 1

Demtime mekanike në %, nuk lejohen

Gjethet të verdha e të lagura, karabush të mëdhenj, të gjate e të kalbur, nuk lejohen

Qepe e thate: Kerkohet cilesia e pare, te jete me pjekuri te plote, me cipe e bisht te thate, te shendosha e te plota, me ngjyre e forme tipike te kultivarit dhe me gjatesi te bishtit deri ne 7 cm.

-Madhesia e kokrres per ovalet te jete nga 4-8 cm dhe per llojet e tjera 5-10 cm.

-Lejohen jo me shume se 1 % e partise me demtime te lehta dhe 1 % lende te huaja.

-Me semundje nuk lejohen.

-Te ngrira, te kalbura e te mykura nuk lejohen.

Speci: Kerkohet cilesia e pare, te jene me forme e ngjyre te kultivarit, te fresketa, te pastra dhe me pjekuri natyrale.

-Lejohen demtime jo me shume se 3 %

-Shija te jete karakteristike e kultivarit. Lejohet shije djegese e lehte. Nuk lejohet perzierja e specave djeges me ato jo djeges.

-Gjatesia te jete per te gjatat mbi 10 cm dhe per te rrumbullaktat mbi 7 cm.

Lakra: Kerkohet cilesia e pare, te jene te zhvilluara, me mbeshjtjellje fletesh, e forte ne prekje. Lejohen lakra te pa ngjeshura deri ne 5 % te partise.

-Te jene te pastra dhe me 2-3 gjethe te gjelbera, te lidhura me koçanin i cili te jete deri ne 3 cm.

-Lejohen deri ne 5 % e partise me demtime te lehta mekanike, te çara lehtesisht e te shperthyera si dhe te demtuara lehtesisht nga bryma.

-Me semundje nuk lejohen.

-Pesha e kokrres te jete jo me pak se 1 kg per lakren e hershme dhe per pjekje te mesme e te vona jo me pak se 1.5 kg.

Preshti: Kerkohet cilesia e pare, te jete i fresket, i njome, i paster, me gjyre te bardhe e jeshile, i pa vyshkur dhe i lare me uje te pijshem.

-Diametri ne pjesen me te trasse tejete mbi 2.5-3.5 cm.

-Gjatesia e kercellit te jete 25-45 cm.

-Gjatesia e gjethit nga rozeta te jete jo me shume se 20 cm.

-Sistemi rrenjor te jete jo me shume se 1 cm.

-Demtime e semundje nuk lejohen.

Spinaq: Kerkohet cilesi e pare, i fresket, i njome, i paster me ngjyre jeshile te erret, i pa vyshkur dhe i lare me uje te paster, i lidhur ne dengje te vogla deri ne nje kg.

- Me rrenje te prera
- Gjatesia e kercellit te mos jete me shume se 5 cm
- Te mos kete prani te barerave te tjera.
- Gjethet te jene te plota me gjeresi deri ne 10 cm dhe gjatesi e gjethes deri ne 20 cm.
- Gjethet te jene pa njolla te ngjyres se ndryshkut, pa demtime nga krimbat, pa demtime mekanike, te fresketa dhe te pavyshkuara.

Tranguj: Kerkohet cilesia e pare, te jene te njome, te fresket, te paster, te lare me uje te pijshem, me ngjyre jeshile te pa vyshkura, me ere dhe shije karakteristike .

-Diametri mesatar te jete nga 2.5-3 cm.

-Gjatesia te jete nga 20-30 cm.

-Demtime mekanike nuk lejohen.

Karrota: Kerkohet cilesi e pare, e fresket, e njome, e paster me ngjyre portokalli, e pa vyshkur dhe i lare me uje te paster, me tufa te lidhura ne rrenje .

Gjatesia mesatare 10-15 cm. Ne prerje terthore kompakte e qarte, pa demtime mekanike ose nga semundjet .

Mashurka: Me ngjyre te verdhe ose jeshile, ne varesi te kultivarit. E lehte ne keputje, pa fije te forta, me madhesi 6-10 cm. Te jete e paster, pa demtime mekanike ose nga semundjet.

Patate: Kerkohet cilesia e pare, te jene te plota, te forta, te pastra e te thata, jo jeshile, jo te mbira me ngjyre dhe me sytha tipike te kultivarit.

-Kokrra te jete e pjekur.

-Madhesia e kokrres te jete per pataten dimerore mbi 5 cm dhe per ato verore mbi 4 cm.

-Nuk lejohen te gjelbera, te vyshkura, te mbira, te çara e te prera, te kalbura, zgjebe ne plage, njolla boje hiri e ndryshku, demtime nga krimbi, demtime nga dosa dhe te papastruara nga dherat.

Fasule:

Treguesit organo-leptikë

-Pamja e jashtme: Kokrra të plota, të shëndosha, me formë dhe madhësi sipas llojit (ovale, e rrumbullakët, e gjatë, etj).

-Ngjyra e bardhë.

-Era dhe shija: Pa erë myku dhe cfarëdo ere tjetër të huaj. Pas zierjes të ketë erë të këndshme, pa shije të hidhur ose cfarëdo ere tjetër të huaj.

Treguesit fiziko kimikë

-Lageshtia jo më shumë se 15%.

-Lëndë të huaja jo më shumë se 0.8%.

-Kokrra të thyera jo më shumë se 13%.

-Perzierje kokrrash jo më shumë se 2.2%.

-Dëmtime mekanike nuk lejohen.

-Infeksione ose dëmtime nga insektet nuk lejohen.

Lloji mallit: **Fruta** (*molle, portokalle, banane, etj.*)

Molla: Kerkohet cilesia e pare, me forme, ngjyre e shije te kultivarit, pa deformime, me pjekuri teknike te njejte, te shendosha, te pastra, te zhvilluara normalisht, pa ere e shije te huaja.

-Lejohen edhe kokrra pa bisht, por pa difekte rreth bishtit.

-Madhesia e kokrrs te jete jo me pak se 60 mm ne prerje ne gjatesi.

- Demtime te ndryshme mekanike lejohen deri ne dy njolla jo te zeza, te vogla, te lehta per kokerr.
- Nuk lejohen te krimbura.
- Njolla te shkaktuara nga dielli ne lekure nuk lejohen.
- Gunga, njolla ne lekure nuk lejohen.
- Njolla nga solucionet kimike ne siperfaqen e kokrres lejohet deri ne $\frac{1}{4}$ e siperfaqes se frutit.

Portokalle: Kerkohet cilesia e pare, ngjyre karakteristike e kultivarit e verdhe ne portokalli me ere karakteristike dhe shije të embel ne të athet, pa shije të hidhur.

- Madhesia e kokrres (diametri me i madh) ne mm jo me pak se 70.
- Demtime mekanike nuk lejohen
- Të prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen.
- Të kalbura, të mykura dhe të fermentuara nuk lejohen.
- Lende të huaja nuk lejohen.
- Gervishtje ne siperfaqe por pa prekur tulin nuk lejohen.
- Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagie të siperfaqes se tyre nuk lejohen.
- Të prekura nga oleooza lejohen 2 – 3 njolla per kokerr.

Mandarina: Kërkohet cilesia e parë.

Pamja e jashtme: të fresket, me zhvillim normal ,të shendoshe. Me pjekuri teknike të plote. Ngjyra, shija dhe aroma. Ngjyre karakteristike e kultivarit e verdhe ne portokalli me ere karakteristike dhe shije të embel ne të athet, pa shije të hidhur. Demtime mekanike nuk lejohen. Të prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen. Të kalbura, të mykura dhe të fermentuara nuk lejohen. Lëndë të huaja nuk lejohen. Gervishtje ne siperfaqe (por pa prekur tulin) nuk lejohen. Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagie të siperfaqes se tyre nuk lejohen. Të prekura nga oleooza lejohen 2 - 3 njolla per kokerr. Permbajtja e pesdiciteteve të jete sipas normave të miratuara nga Ministria e Shendetesise.

Pjeshka: Kerkohet cilesia e pare, kokrra te jete e fresket, me zhvillim normal, me ngjyre karakteristike te kultivarit, te pasterta, pa bishta, me shije te embel dhe ere kerakteristike te kultivarit. Te jete me pjekuri te plote teknike. Madhesia e kokrres te jete per te hershmet deri ne 50 mm, gjysem te hershme deri ne 55 mm dhe te vonshme deri ne 60 mm. Demtime te lehta mekanike nuk lejohen. Demtime nga semundjet, insektet, dielli, ndryshim ngjyre te jete jo me shume se 5 %. Te mykura, te fermentuara, te kalbura dhe lende te huaja nuk lejohen.

Banane: Kerkohet cilesi e pare , te fresketa , me zhvillim normal , ne tufe , me pjekuri teknike te plote:

- Ngjyra te jete jeshile ne te verdhe me ere dhe arome te kendeshme karekteristike kultivari.
- Madhesia e kokrres te jete mesatare.
- Demtime mekanike nuk lejohen
- Njolla te kafeta qe tregojne tejkalimin e pjekurise nuk lejohen
- Gervishtje te lekures nuk lejohen

- Zbutje te lekures nuk lejohen.
- Amballazhimi te jete ne kuti kartoni standarte tipike per tregetimin e bananes.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Operatori i kontraktuar, në bazë të kontratës, përgatit ushqimin në një kuzhinë për të gjithë pacientët e shtruar të Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, bazuar në përcaktimin dietik për pacientin në forcën ditore dhe më pas e shpërndan deri tek shtrati i pacientit. Gjithashtu, përgatit racionet e ushqimit për personelin mjekësor që ndodhet në shërbim 24 orësh.
- Operatori i kontraktuar e transporton ushqimin e përgatitur nga kuzhina deri në pavion, për të gjithë të sëmurët dhe personelin në shërbim, me mjetet, pajisjet dhe enët e veta si dhe po me mjetet e veta kryen shpërndarjen deri tek shtrati i pacientit.
- Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë, në çdo pavion, ka caktuar një dhomë të veçantë (minikuzhinë) që përdoret për mbajtjen e inventarit dhe për shpërndarjen e ushqimit i cili është dhënë në përdorim operatorit ekonomik për ta mirëmbjatur dhe kryer shërbimin.
- Ushqimi ndahet brënda në pavione sipas nevojave aktuale të dokumentuar.
- Operatori i kontraktuar përgatit racionet e ushqimit sipas nevojave kalorike të dietave në pasqyrat bashkëlidhur, të numrit të sëmurëve të shtruar, si dhe të personelit mjekësor që është në shërbim 24 orë.
- Numri i të sëmurëve del nga fletët e forcës së kërkesave ditore që plotësohen nga Kryeinfermierët dhe shefat e shërbimeve të pavioneve dhe i dorëzohen përgjegjësit të kuzhinës së operatorit të kontraktuar çdo ditë, brenda orës 13.00, për ditën e nesërme.
- Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, së bashku me grupin e punës harton procesverbalin e marrjes në dorëzim bazuar në fletët e forcës së kërkesave ditore, përfshirë edhe numrin e personelit mjekësor në shërbim 24 orë.
- Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, bazuar në fletët e forcës së kërkesave ditore, në fillim të çdo muaji, harton pasqyrën përmbledhëse me numrin e të sëmurëve dhe personelit mjekësor sipas dietave për muajin paraardhës. Kjo pasqyrë, pasi rakordohet, firmoset nga përfaqësuesit e të dy paleve dhe shërben si bazë për kryerjen e pagesës çdo muaj nga Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë për operatorin e kontraktuar.
- Operatori i kontraktuar shpërndan dhe servir ushqimin në pavionet e shërbimit sipas dietave.
- Operatori i kontraktuar përgatit ushqimin sipas menusë së hartuar prej tij (sipas dietave të caktuara), miratuar edhe nga Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë, e ndan në racione dhe e shpërndan në pavione 3 herë në ditë: në mëngjes në orën 7.00-8.00, në drekë në orën 11.30-12.30 dhe në darkë, në orën 18.00-19.00, ose oraret e shpërndarjes së ushqimit sipas vakteve (mëngjes, drekë, darkë) do të përcaktohen nga dy palët në momentin kur nënshkruhet kontrata me operatorin ekonomik fitues.

- Operatori i kontraktuar zbaton kërkesat e ligjit nr. 9663, datë 28.01.2008 “*Për ushqimin*” i ndryshuar , për furnizimin me artikujt ushqimorë në brendësi të kuzhinës si dhe për ruajtjen e higjenës së mjedisit dhe personelit.
- Inventari i imët (pjata, lugë, pirunj, tabaka etj.) janë pronë e sipërmarrësit. Pastrimin e mëtejshëm e kryen operatori i kontraktuar. Në pavionet infektive paisjet janë të veçanta dhe njëpërdorimshe.
- Operatori i kontraktuar përgatit dhe shpërndan ushqimin për personelin mjekësor që është në shërbim 24 orë, në vendet që do të caktohen nga Spitali për këtë qëllim.
- Furnizimi me energji elektrike dhe ujë për ambjentin e gatimit, kryhet në bazë të kontratave të lidhura nga operatori i kontraktuar me ndërmarrjen furnizuese përkatëse.
- Operatori i kontraktuar kryen pastrimin e mjediseve që i janë vënë në dispozicion dhe heqjen e mbeturinave në vendet e caktuara nga Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë.
- Operatori i kontraktuar shpërndan ushqimin për çdo të sëmurë dhe personelin mjekësor me bazën materiale dhe pajisjet e minikuzhinave të siguruar me fondet e veta. Ai kryen gjithashtu edhe larjen dhe dizinfektimin e inventareve të imta dhe paisjeve që përdoren brenda pavionit.

Kërkesa mbi organizimin e shërbimit

- Përgatitja e meny-së për pacientët duhet të përcaktohet sipas dietave në këtë relacion për Kilo/kalori ku vendosja e proteinave-karbohidrateve-yndyrnave, të ketë një shpërndarje të rregullt të kalorive dhe makronutrientëve në vaktet përkatëse jo vetëm brenda një dite por edhe gjatë gjithë ditëve të javës.
- Përgatitja e meny-së për personelin mjekësor të shërbimit 24-orë duhet të përcaktohet sipas dietës në këtë relacion Kilo/kalori ku vendosja e proteinave-karbohidrateve-yndyrnave të ketë një shpërndarje të rregullt të kalorive dhe makronutrientëve në vaktet përkatëse jo vetëm brenda një dite por edhe gjatë gjithë ditëve të javës.
- Përgatitja dhe servirja e ushqimit do të kryhet në bazë të kërkesë porosisë ditore të dhënë nga Autoriteti Kontraktor .
- Oraret e shpërndarjes së ushqimit sipas vakteve (mëngjes, drekë, darkë) do të përcaktohen nga dy palët në momentin kur nënshkruhet kontrata me operatorin ekonomik fitues.
- Servirja e ushqimit të kryhet e ngrohtë me tabaka, ku për personelin mjekësor ushqimi të jetë i paketuar në vasketa prej alumini (ose paketime të tjera të propozuara të shëndetshme dhe miqësore me mjedisin)sipas vakteve dhe orareve që do të përcaktohen nga palët.
- Servirja e ushqimit të kryhet deri tek shtrati i pacientit, mjeku i shërbimit nën mbikqyrjen e personit të autorizuar, të caktuar nga ana jonë.
- Produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve duhet të jenë në përputhje me standartet e kërkuara në aktet normative në fuqi. (*“Ligji për Ushqimin”, ISO 9001:2008, HACCP*)

- Transporti i ushqimit të kryhet me furgona të mbyllur termoizolues të cilët pas çdo furnizimi duhet të lahen, pastrohen e dizifektohen konform rregullave dhe kërkesave të HACCP.
- Punonjësit e operatorit ekonomik fitues në momentin e shërbimit të ushqimit në ambientet e spitalit duhet të jenë të pajisur me uniformën, veshjen përkatëse të punës (*përparëse, grykëse, këpucë, pantallona, këpucë*), këta të fundit të jenë të pajisur me librezë shëndetësore si dhe të kontrollohen në mënyrë periodike dhe sa herë është e nevojshme nga Inspektoriati i Higjenës.

III.2.3. Në procesverbalin “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim” të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) autoriteti kontraktor ka argumentuar specifikimet teknike të shërbimit objekt ankimi dhe kriteret e përzgjedhjes së fituesit të përcaktuara në Seksionin 4 “Procedura”, pika 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë””, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Argumentimi i kriteve të pikezuara dhe menyrës së llogaritjes së pikeve:

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (në vijim “LPP”), konkretisht pika 1 e nenit 87 të LPP, ku parashikohet se: “Autoritet/entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme”, të cilat lënë në diskrecionin e AK përcaktimin e menyrës së vlerësimit, si dhe duke vlerësuar natyrën e objektit të prokurimit për secilin lot, dhe proceset që përfshin ky shërbim, AK vlerëson më të përshtatshme dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht të favorshme, për arsyet si më poshtë (në mënyrë të përmbledhur):

Kjo metodë vlerësimi nxit konkurrencë cilësore, shmang praktikën e ofertave jo reale, pasi siguron AK se ofertuesit kanë përllogaritur me saktësi burimet dhe shpenzimet, lejon përfshirjen e elemnetëve të qëndrueshmërisë/kostot mjedisore.

Vendosja e kriteve sociale dhe mjedisore në këtë procedurë prokurimi synon të sigurojë një shërbim që jo vetëm përmbush kërkesat teknike, por gjithashtu mbështet objektivat e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale, në përputhje me ligjislacionin kombëtar dhe direktivat e BE-SË. Përfshirja e këtyre kriteve ndihmon në përmirësimin e kushteve të

punës, zvogëlimin e ndikimit mjedisor përmes praktikave të gjelbra dhe menaxhimit të mbetjeve, të gjeneruara nga ushqimi pro jo vetëm, sigurimin e një vlerë të qëndrueshme për paranë publike, përtej çmimit të ofertës.

Detajimi i shpërndarjes së pikëve për secilin lot të procedurës së prokurimit është vlerësuar si vijon:

Shpërndarja e pikëve, për cdo Lot si më poshtë:

Kriteri:

- | | |
|--|----------------|
| 1. Çmimi | 70 pikë |
| 2. Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi | [0- 10] pikë |
| 3. Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm | – [0-10] pikë |
| 4. Transporti ekologjik | [0-10] pikë |

Argumentimi i kriterëve të pikezuara dhe menyrat e llogaritjes së pikëve:

- | | |
|-----------|---------|
| 1. Çmimi: | 70 pikë |
|-----------|---------|

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$P_{kl} = V_{minkl} \times P_{maxkl} / O_{kl}$

P_{kl} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{minkl} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxkl} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{kl} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

- 2. Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi [0- 10] pike***

Argumentim: Ofertuesi duhet të propozojë një plan veprimi për parandalimin e mbetjeve ushqimore. Ky plan përfshin (por pa u kufizuar në):

- *një analizë e të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve ushqimore;*
- *kryerjen e matjeve të sasive të mbetjeve ushqimore në mënyrë të vazhdueshme ose periodike (duke u bazuar në kontrata të mëparshme apo analiza empirike profesionale);*
- *hartimin e strategjive për parandalimin e teprimit të ushqimeve, duke përfshirë (por jo vetëm) garantimin e ruajtjes së ushqimit në kushtet e duhura, magazinim efikas, blerje rregullisht në sasi të duhura të lëndës së parë me të cilat do të përgatiten dietat, angazhim të oferteutit në projekte sociale, etj.*

Kërkesa për planveprimin e Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi është një dokument kryesor në zbatimin e kontratës, i cili do ta shoqerojë deri në fund atë, pasi zbatimi i masave të tilla përbën një element të rëndësishëm në vlerësimin e cilësisë së shërbimit, duke reflektuar angazhimin për efikasitet ekonomik dhe mbrojtje mjedisore.

Parandalimi i gjenerimit të mbetjeve ushqimore përbën një masë të rëndësishme për garantimin e një shërbimi efikas, ekonomik dhe të qëndrueshëm. Në kontekstin e ofrimit të shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, minimizimi i ushqimit të papërdorur ndihmon në uljen e kostove operative, përmirëson higjenën në ambientet spitalore duke shmangur rreziqet nga kontaminimi dhe redukton ndikimin negativ në mjedis. Ofruesit e shërbimit inkurajohen të paraqesin masa konkrete për planifikimin e racioneve, përdorimin optimal të lëndëve të para dhe në përputhje me parimet e prokurimit të gjelbër.

Ushqimi i hedhur përbën një burim të madh ndotjeje, pasi gjatë dekompozimit mbetjet organike çlirojnë gazra serrë, elemente të dëmshëm mjedisor.

Nga ana tjetër, duke qenë se hedhja e ushqimit ka ndikim në aspektin social e etik, inkurajimi i praktikave si dhurimi i ushqimit të paprekur (në kushte të sigurt), bashkëpunimi me OJF për mbështetjen e grupeve vulnerabël, etj., mund të ndihmojë komunitetet në nevojë. Operatore ekonomike me përvojë në dhurimin e produkteve ushqimore kanë qasje me sociale dhe ndikojnë drejtpërdrejtë në prokurimin e qëndrueshëm duke optimizuar shpenzimet me anë të shpërndarjes së ushqimeve për kategori sociale në pamundësi.

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

a. Cilesia e planveprimit në aspektin mjedisor: 0- 5 pike

b. Cilesia e planveprimit në aspektin social: 0-5 pike

**Vlerësimi me pike do të bëhet duke analizuar përfshirjen e elementeve të argumentimit duke mos u kufizuar në to. Me 0 pike do të vlerësohen operatorët ekonomikë të cilët nuk paraqesin fare planveprim ose një planveprim që nuk përmban asnjë të dhënë të përshkruar në argumentim. Ndërsa pikezimi 1-5 pike do të bëhet duke u bazuar në cilësinë dhe përshkrimin e elementeve të argumentimit.*

3. Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm – [0-10] pikë

Argumentim: Ofertuesi duhet të zbatojë një plan për reduktimin e ambalazheve të panevojshme dhe përdorimin e paketimit të qëndrueshëm.

Ky plan duhet të përfshijë (por pa u kufizuar në):

- përpilimin e inventarit të mbetjeve: duke analizuar të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve të tjera (përveç mbetjeve ushqimore);*
- reduktimin e mbetjeve në blerjen e lëndëve të para, me të cilat do të përgatiten racionet (dietat): zgjedhja e llojit të duhur të paketimit për të reduktuar mbetjet (p.sh.*

paketim të ripërdorshëm), paketim të riciklueshëm dhe kthimi i paketimit për ripërdorim vetëm në raste kur kjo është e mundur dhe nuk çënon sigurinë e ushqimit;

- *reduktimin e mbetjeve në shërbimin e kateringut: shmangia e artikujve me ambalazh dytësor të panevojshëm ose të tepërt, përdorimi i kontenitorëve që mund të rimbushen (për erëza), etj.*

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

Në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimit të politikave të prokurimit të gjelbër, zgjedhja e llojit të duhur të paketimit gjatë blerjes së produkteve ushqimore përbën një element kyç në reduktimin e mbetjeve dhe ndikimit negativ në mjedis.

Paketimi i thjeshtë, funksional dhe i biodegradueshëm ndihmon në:

- *Reduktimin e volumit të mbetjeve të ambalazhit, të cilat përndryshe përbëjnë një ngarkesë të konsiderueshme për mjedisin, zvogëlimin e përdorimit të materialeve plastike dhe ambalazheve dytësore (paketime të panevojshme brenda paketimeve), të cilat janë shpesh jo të riciklueshme dhe pa funksion real ruajtës;*

- *Sigurimin e ruajtjes më të mirë të produkteve ushqimore, duke garantuar jetëgjatësi më të madhe, kontroll cilësor dhe mbrojtje ndaj ndotjes apo dëmtimeve gjatë transportit dhe shpërndarjes;*

Vleresimi do të bëhet si më poshtë:

a. Plani i veprimit për ambalazhimin e panevojshëm dhe metodologjia e mbledhjes dhe perpunimit të këtij ambalazhi 0-5 pike

**Vleresimi me pike do të bëhet duke analizuar përfshirjen e elementeve të argumentimit duke mos u kufizuar në to. Me 0 pike do të vlerësohen operatorët ekonomikë të cilët nuk paraqesin fare planveprim ose një planveprim që nuk përmban asnjë të dhënë të përshkruar në argumentim. Ndërsa pikezimi 1-5 pike do të bëhet duke u bazuar në cilësinë dhe përshkrimin të elementeve të argumentimit.*

b. Lloji i paketimit i zgjedhur i cili mund të jetë i biodegradueshëm ose i riciklueshëm 5 pike. Nëse për këtë kriter nuk paraqitet asnjë dokument, ose asnjë dokument që të vertetojë se paketimi i propozuar nuk ka elemente pro mjedisore vlerësohet me 0 pike.

- *Ky kriter do të vlerësohet bazuar në dokumentacion faktik siç është një marrëdhënie e deshmuar me një prodhues apo distributor të paketimeve ushqimore. Në marrëdhënie është me distributor të autorizuar do të vertetohet marrëdhënia e distributorit me*

prodhuesin. Ne aktet provuese duhet te pershkruhet natyra e paketimit nese eshte e riciklueshme, e biodegradueshme apo e ndonje lloji tjetër, miqesore me mjedisin.

4. Transporti ekologjik [0-10 pike]

Argumentim: Ofertuesi duhet të dëshmojë se shërbimi i transportit të ushqimit deri në ambientet e AK, do të realizohet me mjete transporti me emetime të ulëta, si më poshtë:

- përdorimin e mjeteve të transportit frigoriferik te llojit elektrik ose hybrid ose cdo lloj tjetër automjeti transporti i cili ka emetimin me te ulet te co2 te provuar me dokumentacion.

Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për spitalet është një proces i përditshëm, me frekuencë të lartë shpërndarje, përdorim të mjeteve transportuese dhe konsum të konsiderueshëm paketimi dhe energjie, duke sjellë ndikime direkte në mjedis.

Kërkesa për përdorimin e mjeteve frigoriferike elektrike/ hibride dhe me pak emetime kontribuon jo vetëm në uljen e ndotjes në mjedisin ku këta mjete qarkullojnë, por edhe në zvogëlimin e ndotjes globale dhe përmbushjen e objektivave të klimës. Automjeti i propozuar do të levizë minimalisht tre here në ditë për shpërndarjen ushqimore, kështu që frekuenca e levizjes dhe ndotja është relativisht e lartë. Për këtë arsye, automjetet me emetime të ulëta janë me miqesore me mjedisin.

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë, dokumentacionin e kërkuar në pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si dhe:

- certifikatë të regjistrimit të mjetit me të dhënat teknike (viti, lloji, standarti EURO)*

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

- Nëse OE disponon një automjet elektrik vlerësohet me 10 pikë, nëse disponon një mjet hybrid vlerësohet me 5 pikë dhe nëse disponon automjet tjetër me emetim të ulët vlerësohet nga 0 (nëse emetimi është i lartë) deri në 4 pikë.***

Baza ligjore për vendosjen e këtyre kriterëve:

LIGJ Nr. 162/2020, PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 79

Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efikasiteti i energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

Neni 87

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomike më të favorshme.

2. Oferta ekonomike më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Neni 25

Kriteret e kualifikimit

*3. Autoritetet/entet kontraktore janë të detyruara që në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-së, si edhe në hartimin e specifikimeve teknike, sipas parashikimeve të nenit 36, të LPP-së, të zbatojnë, përveç këtyre rregullave për prokurimin publik, edhe detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë: a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji; b) **Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;** c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Neni 45

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomike më të favorshme.

2. Oferta, ekonomike më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me

nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Metodologji Udhëzuese për Zbatimin e Prokurimit Publik të Gjellbër Në Shqipëri

4. Kategoritë e produkteve dhe shërbimeve dhe kritere të përzgjedhura të gjelbra të zbatueshme në prokurimin publik (PPGJ)

3. Shërbime të ushqimit dhe kateringut

Fleta udhëzuese 3: Ushqimi dhe shërbimet e kateringut.

III.2.4. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK autoriteti kontraktor në shkresën nr. 1885/11 prot, datë 02.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1697/1 prot, datë 03.07.2025, ka argumentuar, si më poshtë vijon:

“Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim dokumentet e tenderit, procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, për këtë procedurë prokurimi, të publikuar në sistemin e prokurimit elektronik si dhe ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” shpk konstaton se kriteret për përzgjedhjen e ofertës fituese janë bazuar në raportin më të mirë çmim-cilësi, që do të vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë.

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se dokumentet e tenderit janë formuluar duke përmbytur dy faza, **së pari, fazën e përzgjedhjes** ku përfshihen kriteret e veçanta të kualifikimit dhe në përfundim të saj përzgjidhen dhe kualifikohen operatorët ekonomikë ofertat e të cilëve klasifikohen si të vlefshme dhe **së dyti, faza e përzgjedhjes së operatorit ekonomik i cili do të shpallet fitues në varësi të raportit çmim-cilësi sipas kritereve të përcaktimit të ofertës fituese**.*

Ky kriter i pikëzuar është hartuar në mbështetje dhe harmoni të plotë me kriterin e vlerësimit sipas pikës 2.3.3 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit si dhe në propocion me parashikimet e pikës 2, gërma “a”, të Nenit 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndyshuar, parashikohet se: “Kritere të tilla mund të përfshijnë: a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimiri për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij.”’. Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor mund të përdorë kriterin e ofertës më të mirë ekonomikisht dhe teknikisht ku përfshihet cilësia, në rastin konkret karakteristikat mjedisore dhe novatore.

KSHA konstaton se lidhur me kriterin e peshës/përzgjedhjes së fituesit: “Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi” [0 - 10] pike”, operatori ekonomik ankimues nuk ka asnjë pretendim, nuk ngre asnjë arsye lidhur me hartimin e këtij kriteri, i cili potencialisht mund të ndikonte në aftësitë e tij ofertuese.

Gjithashtu, vendosja e një elementi të vlerësimit teknik me pikë të shkallëzuara (0-10 pikë) për paraqitjen e planit të veprimit për minimizimin e gjenerimit të mbetjeve ushqimore është

plotësisht e ligjshme, proporcionale dhe **në përputhje me parimet e prokurimit të gjelbër e social** si dhe **vlerësimit cilësor të ofertave**.

Lidhur me një ndarje të qartë dhe objektive të pretenduar nga operatori ekonomik ankimues, KSHA thekson se qartazi ky kriter përmban edhe nëndarje të cilat japin një pasqyrim të plotë të mënyrës së ofertimit, në cilësinë e hartimit dhe paraqitjes së planveprimit të parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi, konkretisht:

1. Cilesia e planveprimit ne aspektin mjedisor: 0- 5 pike
2. Cilesia e planveprimit ne aspektin social: 0-5 pike

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se, mënyra e vlerësimit, pretenduar nga operatori ekonomik ankimues, është mirëpërcaktuar në dokumentet e tenderit:

* Vlerësimi me pike do të behet duke analizuar perfshirjen e elementeve te argumentimit duke mos u kufizuar ne to. Me 0 pike do te vleresohen operaloaret ekonomike te cilët nuk paraqesin fare planveprim ose nje planveprim qe nuk permban asnje te dhene te pershkruar ne argumentim. Ndersa pikezimi 1-5 pike do te behet duke u bazuar ne cilesine dhe pershkrimin te elementeve te argumentimit. ”

Pra një planveprim i cili do të marrë pikët maksimale përsa i përket aspektit mjedisor ose social është një plan i strukturuar në mënyrë të qartë, përfshin masa parandaluese, teknika të matshme, ndarje përgjegjësish, monitorim, përmbajtje të elementëve novatorë dhe mbi të gjitha është i aplikueshëm në praktikë por siç edhe theksohet qartazi në dokumentet e tenderit, pa u kufizuar në to. **Në këtë kuadër, pas vlerësimit me pikë maksimale, për vlerësimin në vijim, në varësi të mangësive të mundshme zbatohet formula dhe parimi i kriterëve me trend zbritës.**

Lidhur me kriterin: “Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm [0 - 10] pike”, operatori ekonomik ankimues konstaton shprehimisht se: “Ky kriter është teknikisht i saktë dhe në përputhje **me objektivat e prokurimit të gjelbër**”. Pra, konstatohet se ankimuesi nuk kundërshton saktësinë apo përmbajtjen e vetë kriterin të vendosur nga autoriteti kontraktor, por ka paraqitur pretendime në lidhje me mënyrën e vlerësimit të tij, pretendime këto të pambështetura pasi, Vlerësimi me pikë është një mënyrë e njohur dhe e mbështetur ligjërisht dhe përdorimi i sistemit të pikëve siguron objektivitet dhe diferencim real. Vlerësimi me pikë mundëson një analizë graduale, (në rend zbritës) në kuptimin e vlerësimit me pikë maksimale të atyre operatorëve ekonomikë që ofrojnë zgjidhje të plota, të strukturuar dhe të zbatueshme dhe në vijim krijimin e diferencimit transparent dhe të matshëm ndërmjet ofertave, që ndryshe do të trajtoheshin në mënyrë binare. Lidhur me formën e dokumentacionit provues, është përcaktuar qartazi në dokumentet e tenderit se duhet të paraqitet një dokument i shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

Për sa i përket kriterit “Transporti ekologjik [0-10] pike, në dokumentete e tenderit është përcaktuar qartë metoda e vlerësimit: “Nese OE disponon nje aufomjet elektrik vlerësohet me 10 pikë, nëse disponon një mjet hybrid vlerësohet me 5 pikë dhe nëse disponon automjet tjetër me emetim të ulët vlerësohet nga 0 (nëse emetimi është i lartë) deri ne 4 pikë ”.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Dajti Park 2007" shpk, lidhur me mënyrën e vlerësimit janë te pabazuara pasi autoriteti kontraktor ka ndjekur një metodologji të njohur dhe bazuar ligjërisht e cila siguron objektivitet, barazi trajtimi dhe vlerësim real të cilësisë së

ofertave. Për rrjedhojë, kriteret e perzgjedhjes së fituesit janë të qarta dhe të përshtatshme, dhe mënyra e zbatimit të tyre është e ligjshme dhe transparente.

KSHA konstaton se operatori ekonomik ankimues "Dajti Park 2007" shpk nuk kundërshton kriteret e perzgjedhjes së fituesit por ka paqartësi në lidhje me plotësimin e tyre. Në këtë kontekst, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarim pranë AK, parashikuar në pika 1 e nenit 75 të LPP, ku përcaktohet se: "1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave."

Gjithashtu, parimi i ushtrimit të diskrecionit në vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për perzgjedhjen e kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese, i nënshtrohet edhe rregullimeve të nenit 11 "Parimi" i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ku përcaktohet se:

"Diskrecioni ushtrohet ligjerisht kur at iishle ne perputhje me kushlet e meposhtme.

- a) është i parashikuar me ligj;
- b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit,
- c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe
- d) zgjedhja nuk përben një shpangje të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në rast të njëjta apo të ngjashme."

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron."

III.2.5. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se:

"Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."

III.2.6. Ndërkohë në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është

ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.7. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.2.8. Në nenin 87 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.*

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Kriteret e tilla mund të përfshijnë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit. Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës”.

III.2.9. Në nenin 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Në rastin kur, oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet Vmink1 Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = Ok1 \times Pmaxk1 / Vmaxk1$$

Vmaxk1 _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

9. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë jo më pak se 20 pikë dhe propozimi teknik jo më pak se 80 pikë. Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 dhe më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse.

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është: Oferta më e mirë = $X + Y$

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

a) Për kriteret, që mund të përdoren për propozimet teknike, autoriteti ose enti kontraktor mund të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

i. Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit;

ii. cilësinë e metodologjisë së propozuar;

iii. kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.

Nënkriteret e kriterëve të vlerësimit teknik do të përcaktohen në dokumentet standarde të tenderit për shërbimet.

b) Vlerësimi i propozimeve ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për propozimin ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$Pe = 100 \times \text{Çu} / \text{Ç}$ (çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik).

III.2.10. Në nenin 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore” të Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod, klasifikohen si vijon:

a) mjete që lëvizin me forcën e krahut;

b) mjete të tërhequra me kafshë;

c) mjete me pedal;

d) slita;

e) ciklomotori;

f) motomjete;

g) automjete;

h) trolejbusë;

i) rimorkio;

j) makina bujqësore;

k) makina teknologjike;

l) mjete rrugore të veçanta.

2. Mjete me motor dhe rimorkiot e tyre, sipas shkronjave “e”, “f”, “g”, “h”, “i” “j” dhe “l”, të pikës 1, të këtij neni, klasifikohen, gjithashtu, në bazë të kategorive ndërkombëtare si më poshtë:

a) - *Kategoria L1: mjete me dy rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h, fuqia maksimale nuk është më shumë se 4 kË në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L2: mjete me tri rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h; rendimenti maksimal neto i fuqisë nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme nuk është më shumë se 4 kË, **në rastin e një motori elektrik;***

- *Kategoria L3: mjete me dy rrota, pa kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L4: mjete me dy rrota, me kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie 35 të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L5: mjete me tri rrota të përshtatura simetrikisht, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L6: mjete me katër rrota të lehta, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 350 kg, pa përfshirë masën e baterive **në rastin e automjeteve elektrike**, me shpejtësi maksimale të projektuar jo më të madhe se 45 km/h, cilindrata e motorit të mos i kalojë 50 cm³ dhe rendimenti maksimal neto i të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme e të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L7: mjete me katër rrota të ndryshme nga L6, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 400 kg (550 kg për automjetet e synuara për transportimin e mallrave), pa përfshirë masën e baterive, **në rastin e automjeteve elektrike, dhe fuqia maksimale neto e motorit e të cilave nuk është më shumë se 15 kË;***

b) - *kategoria M: mjete me motor të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria M1: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që nuk kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit;*

- *kategoria M2: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë deri 5 tonë;*

- *kategoria M3: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 tonë;*

c) - kategoria N: mjete me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota;

- kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë;

- kategoria N2: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 12 tonë;

- kategoria N3: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë;

d) - kategoria O: rimorkiot (përfshirë edhe gjysmërimorkiot);

- kategoria O1: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0,75 tonë,

- kategoria O2: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0,75 tonë, por jo më të madhe se 3,5 tonë;

- kategoria O3: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë;

- kategoria O4: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë.

dh) - Kategoria T: traktorët me rrota;

- Kategoria T1: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me boshtin më të afërt te drejtuesi, që ka gjerësi minimale zinxhiri prej jo më pak se 1150 mm, me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 1 000 mm;

- Kategoria T2: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me gjerësi minimale zinxhiri prej më pak se 1150 mm, e një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 600 mm;

- Kategoria T3: traktorët e pajisur me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h dhe me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej jo më shumë se 600 kg;

- *Kategoria T4: traktorët e pajisur me rrota për qëllime të veçanta, me shpejtësi maksimale në 36 kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria T5: traktorët e pajisur me rrota me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria C: traktorët me zinxhirë të pandërprerë; Traktorët me zinxhirë të pandërprerë që shtyhen dhe drejtohen nga zinxhirë të pandërprerë dhe kategoritë e të cilëve, C1 deri C5, përcaktohen në analogji me kategoritë T1 deri T5.*

III.2.11. Në nenin 79 “Kontrolli teknik”, pika 1, të Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Ministri, që mbulon veprimtarinë përkatëse, përcakton, me urdhër dhe udhëzim të veçantë, kriteret, kohën dhe mënyrat e kryerjes së kontrollit teknik të kategorive të mjeteve me motor dhe të rimorkiove, për të garantuar sigurinë dhe qetësinë në qarkullim dhe se ndotja e shkaktuar prej tyre nuk i kalon kufijtë e përcaktuar. Kontrollat teknike kryhen në qendrat e kontrollit teknik, të licencuara nga ministria, që mbulon veprimtarinë përkatëse, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet në fuqi. Në udhëzim përcaktohen elementet, për të cilat duhet të kryhet kontrolli teknik i sistemeve të mjeteve, që kanë rëndësi për sigurinë e tyre.

Prodhuesit dhe përfaqësuesit e tyre u transmetojnë qendrave të kontrollit teknik informacion për sistemet dhe pajisjet e mjeteve për të cilat kryhet kontrolli teknik në mënyrë të vazhdueshme, në kohë, pa kufizim, me qasje të lehtë dhe jodiskriminuese. Informacioni vihet në dispozicion 6 muaj pas regjistrimit të mjetit.

Bëjnë përjashtim rastet e parashikuara në pikat 6 dhe 8 të këtij neni për të cilat informacioni transmetohet sipas kërkesës dhe pa vonesa.”.

III.2.12. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 633, datë 26.10.2018 “Për Masat Kundër Ndotjes së Ajrit nga Shkarkimet e Mjeteve Motorike dhe Reduktimin e Shkarkimeve në Ajër të Ndotësve të Gaztë dhe të Lëndës së Ngurtë Pezull nga Motorët me Ndezje Pozitive dhe ata me Ndezje me Kompresion që Djegin Gaz Natyror apo të Lëngshëm për Përdorim në Automjete”, i ndryshuar, parashikohet se:

I. Dispozita të Përgjithshme

1. Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga shkarkimet e ndotësve të gaztë prej mjeteve motorike dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion, që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete, nëpërmjet përcaktimit të kushteve të importit të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe kushteve për mjetet ekzistuese në qarkullim.

2. Ky vendim zbatohet për mjetet motorike të kategorisë M (M1, M2) për transport njerëzish dhe N (N1) për transport mallrash.

3. Ky vendim nuk zbatohet për importin e:

a) Automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi, siç janë:

i. automjetet e prodhuara deri në dhjetor 1970;

ii. automjetet e prezantuara si model i prodhimit deri më 31 dhjetor 1970, pavarësisht vitit aktual të prodhimit të një automjeti të veçantë;

iii. automjetet, të cilat paraqesin vlera teknike muzeale apo kulturore, trashëgimi tradicionale dhe sociale.

b) Mjeteve motorike, të cilat janë të importuara nga subjekte fizike e juridike, me qëllim ndihmën humanitare, në përputhje me legjislacionin kombëtar që rregullon donacionet dhe ndihmat humanitare.

4. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Ndotës të gaztë”, janë shkarkimet e gazta të monoksidit të karbonit (CO), oksideve të azotit të shprehura si ekuivalent i dyoksidit të azotit (NO₂) dhe hidrokarbureve në total (THC), përfshirë lëndë të ngurta pezull (PM);

b) “Mjete motorike kategoria M dhe N”, janë mjetet rrugore me motor, sipas përkufizimit në nenin 47, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) “Euro 3”, janë për mjetet motorike, sipas listës së standardeve të vitit 2000, hyrë në fuqi me direktivën 98/69/EC.

ç) “Euro 4”, janë për makinat e pasagjerëve, sipas listës së standardeve të vitit 2005, hyrë në fuqi me direktivën 98/69/EC dhe 2002/80/EC;

d) “Euro 5”, janë për makinat e lehta tregtare dhe të pasagjerëve, sipas listës së standardeve të vitit 2009, hyrë në fuqi me direktivën 715/2007/EC.

II. Masat Kundër Ndotjes së Ajrit nga Shkarkimet e Mjeteve Motorike dhe Reduktimet e Shkarkimeve në Ajër.

5. Përdoruesit e automjeteve, vendës ose të huaj, që qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar t'i përdorin automjetet e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara nga prodhuesi, të pasqyruara në dokumentet dhe instruksionet përkatëse, si dhe të respektojnë normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, të përcaktuara.

6. Kontrollit të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, që shkarkohen nga automjetet rrugore, u nënshtrohen të gjitha automjetet e pajisura me motorë me djegie të brendshme, që përdorin si lëndë djegëse benzinë, naftë dhe gaz të lëngshëm ose natyral, dhe që janë në përdorim nga individë, subjekte fizike dhe juridike.

7. Kontrolli bëhet mbi bazën e normave që përcaktojnë nivelet e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, në përputhje me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis, si dhe për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të.

8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis, si dhe për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit e kërkesat për disa ndotës në lidhje me të dhe në varësi të kategorizimit të automjeteve, sipas peshës e kohës së përdorimit, lejohen të regjistrohen për herë të parë për qarkullim në territorin e Republikës së Shqipërisë, mjetet motorike dhe automjetet, të cilat plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Autoveturat e reja me zero km dhe që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër, të cilat përmbushin normën Euro 5, të Bashkimit Evropian;

b) Mjetet motorike të tjera të reja si motorë, autobusë, kamionë të kategorive M2 dhe N1, me zero km dhe që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër, të cilat përmbushin normën Euro 5, të Bashkimit Evropian;

c) Autoveturat e përdorura, të gjitha ato që nuk janë me zero km dhe që janë regjistruar më parë për qarkullim në rrugë në një shtet tjetër, të cilat përmbushin normën Euro 4;

ç) Mjetet motorike të tjera të përdorura si motorë, autobusë, kamionë, të kategorive M2 dhe N1, (të gjitha ato që nuk janë me zero km dhe që janë regjistruar më parë për qarkullim në rrugë në një shtet tjetër, të cilat përmbushin normën Euro 3) duhet të jenë prodhuar jo më shumë se 15 vjet para datës së regjistrimit të parë në Shqipëri.

9. Automjetet e blera para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, që janë nisur për t'u çliruar për qarkullim të lirë dhe regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe që kanë hyrë në territorin shqiptar brenda datës 31.12.2018 dhe nuk kanë përfunduar procedurat doganore dhe të regjistrimit, kanë afat deri në 31 dhjetor 2019, për kryerjen e procedurave të nevojshme.

10. Automjetet që do të importohen në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me këtë vendim, duhet të përmbushin kushtet teknike lidhur me karakteristikat funksionale të sistemeve dhe të pajisjeve dhe gjendjes tekniko-fizike të tyre, të cilat duhet t'u korrespondojnë mjeteve të parashikuara në pikën 8, të këtij kreu. Këto kushte përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportet.

III. Dispozita të Fundit

11. Ngarkohen autoritetet doganore të kontrollojnë dokumentacionin shoqërues të mjetit motorik dhe të ndalojnë importin e mjeteve motorike që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 4 dhe 8, të këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministra e Infrastrukturës dhe Energjisë, autoritetet doganore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

III.2.13. Referuar përcaktimeve ligjore të sipërcituara, autoritetit kontraktor i është lënë në diskrecion që të zgjedhë ndërmjet dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të çmimit ose në bazë të kostos. Në rastin e dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kostos, në mbështetje të përcaktimeve ligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dy kategori kriteresh, të cilat janë kriteret e kualifikimit dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese (të vlerësimit). Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret e kualifikimit vendosen për të garantuar që një ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kriteret e kualifikimit e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Ndërsa në rastin e kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të përzgjedhur ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi, të cilat detyrimisht duhet të lidhen me objektin e kontratës në fjalë, në bazë të cilësisë, aspekteve mjedisore dhe/ose sociale. Pra, Komisioni gjykon se një prej dallimeve esenciale ndërmjet kriterëve të kualifikimit me kriteret për shpalljen e kontratës fituese është se kriteret e kualifikimit janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, pasi në të kundërt oferta e tyre refuzohet, ndërsa kriteret për shpalljen e kontratës fituese kanë karakter vlerësues për të evidentuar ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi dhe nuk përbëjnë shkak për kualifikimin/skualifikimin e ofertave. Gjithësesi, bazuar në nenin 87 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni gjykon se, pavarësisht se kriteret për shpalljen e kontratës fituese janë me karakter të ndryshëm vlerësimi nga kriteret e kualifikimit, parimi për hartimin e tyre është i njëjtë. Pra, për hartimin e të dy kategorive të kriterëve, autoritetet kontraktore duhet të kujdesen që këto kritere të jenë në përputhje me volumin dhe objektin e kontratës që prokurohet, të jenë të qarta, të sakta, të mos krijojnë konfuzion, si dhe të garantojnë një konkurrencë efektive duke shmangur çdo lloj kufizimi të panevojshëm. Gjithashtu KPP thekson se në rregullat e prokurimit publik, është përcaktuar qartësisht se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë një formulë të qartë mbi mënyrën e

përlllogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Inter Allia dhe Mutatis Mutandis në Çështjen nr. Case 6/15- “*TNS Dimarso NV v Vlaams Gevest*” të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, paragrafi 20, GJED, ndër të tjera ka arsyetuar se: “[*Omississ...* Duhet të theksohet se aty ku autoriteti kontraktor vendos dhënien e një kontrate referuar ofertës ekonomike më të favorshme, sipas nenit 53 (2) të Direktivës 2004/18, ai duhet të specifikojë në njoftimin e kontratës ose specifikimin e tenderit peshën relative të peshimit të tij secilit prej kriterëve të përzgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomike më të favorshme. Peshimi mund të shprehet duke parashikuar një hapësirë mes maksimumit të shpërndarjes. Kur, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, peshimi nuk është i mundur për t’u demonstruar arsyet, autoriteti kontraktues do të përcaktojë në njoftimin e kontratës ose specifikimet e tenderit ose, në rastin e një dialogu konkurrues, në dokumentin përshkrues, kriteret në rend zbritës bazuar në rëndësinë]”.

III.2.14. Në rastin konkret, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi kriteret e përzgjedhjes së ofertës fituese të përcaktuara në Seksionin 4 “*Procedura*”, pika 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe konkretisht për kriteret e përcaktimit të ofertës fituese ka përcaktuar si metodilogji për përcaktimin e ofertës fituese metodën “***Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto***”, duke përcaktuar 4 (katër) kriteret e përzgjedhjes së ofertës fituese dhe konkretisht, si në vijim: “1- Çmimi duke e peshuar me 70 pikë; 2- Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi duke e peshuar nga [0- 10] pikë; 3- Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm duke e peshuar [0-10] pikë dhe 4- Transporti ekologjik duke e peshuar nga [0-10] pikë”.

Duke ju referuar argumentimeve në dokumentat standarte të tenderit të secilit prej kriterëve të sipërcituar Komisioni konstaton se për kriterin “***Çmimi***” autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë metodologjinë e vlerësimit me pikë të këtij kriteri, pasi ka publikuar formulën përkatëse për përlllogaritjen e pikëve për secilën ofertë ekonomike që do të dorëzohet në këtë procedurë prokurimi, sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 45 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, ndërsa për 3 (tre) kriteret e tjera dhe konkretisht kriterin “***Planveprimi i parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi***” të cilin e ka ndarë në 2 (dy) nënkritere përkatësisht nënkriterin “***Cilesia e planveprimit në aspektin mjedisor***” për të cilin ka përcaktuar si vlerësim minimal 0 (zero) pikë dhe si vlerësim maksimal 5 (pesë) pikë dhe nënkriterin “***Cilesia e planveprimit në aspektin social***” për të cilin ka përcaktuar si vlerësim minimal 0 (zero) pikë dhe si vlerësim maksimal 5 (pesë) pikë; kriterin “***Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm***” e ka ndarë në 2 (dy) nënkritere përkatësisht nënkriteri “***Plani i veprimit për ambalazhimin e panevojshëm dhe metodologjia e mbledhjes dhe perpunimit të këtij ambalazhi***” për të cilin ka përcaktuar si vlerësim minimal 0 (zero) pikë dhe si vlerësim maksimal 5 (pesë) pikë dhe nënkriteri “***Lloji i paketimit i zgjedhur i cili mund të jete i biodegradueshëm ose i riciklueshëm***” për të cilin ka përcaktuar si vlerësim minimal 0 (zero) pikë dhe si vlerësim maksimal 5 (pesë) pikë dhe kriterin “***Transporti ekologjik***” për të cilin ka përcaktuar si vlerësim minimal 0 (zero) pikë dhe si vlerësim maksimal 10 (dhjetë) pikë.

III.2.14.1. Lidhur me përcaktimet e bëra nga autoriteti kontraktor për nënkriterin “*Cilesia e planveprimit në aspektin mjedisor*”, Komisioni konstaton se vlerësimi me pikë për këtë nënkriter do të bëhet duke analizuar përfshirjen e elementeve të argumentimit të publikuar në Seksionin 4 “*Procedura*”, pika 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të dokumenteve të tenderit, duke mos u kufizuar vetëm në to dhe konkretisht me 0 (zero) pikë do të vlerësohen operatorët ekonomikë ofertues të cilët **nuk paraqesin fare planveprim në aspektin mjedisor ose që paraqesin një planveprimi në aspektin mjedisor që nuk përmban asnjë të dhënë të përshkruar në argumentimin e këtij kriteri të përmendur më sipër**, ndërsa pikëzimi 1-5 pike do të bëhet duke u bazuar në cilësinë dhe përshkrimin e elementëve të argumentimit.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga përcaktimet e autoritetit kontraktor, Komisioni gjykon se enti prokurues për këtë nënkriter ka përcaktuar vetëm rastet kur ky kriter vlerësohet me 0 (zero) pikë, ndërsa për rastet kur ofertuesit e njëpasnjëshëm paraqesin **një planveprimi në aspektin mjedisor të vlefshëm nuk ka përcaktuar** mënyrën e llogaritjes së pikëve që do ti vlerësojë secilin ofertues të njëpasnjëshëm për këtë nënkriter, duke mospërcaktuar jo vetëm mënyrën e llogaritjes me pikë **të analizës së të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve ushqimore, të kryerjes së matjeve të sasive të mbetjeve ushqimore në mënyrë të vazhdueshme ose periodike (duke u bazuar në kontrata të meparshme apo analiza empirike profesionale) dhe të hartimit të strategjive për parandalimin e teprimit të ushqimeve, duke përfshirë (por jo vetëm) garantimin e ruajtjes së ushqimit në kushtet e duhura, magazinim efikas, blerje rregullisht në sasi të duhura të lëndës së parë me të cilat do të përgatiten dietat, angazhim të oferteusit në projekte sociale, etj**, dokumentacionin që secili ofertues duhet të paraqesë për të përmbushur këtë nënkriter, apo dhe detajimin se çfarë duhet të përmbajë metodologjia pasi vetëm në këtë mënyrë autoriteti do të mund të zbatojë parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit gjatë vlerësimit për secilin kriter, gjithashtu ajo çka është më e rëndësishmja rezulton se gjatë verifikimit të dokumentave standarte të tenderit enti prokurues nuk ka përcaktuar formulën që do të përdoret gjatë procesit të vlerësimit të ofertave për përllogaritjen e pikëve për këtë nënkriter, sikurse përcaktohet në pikës 7 të nenit 45 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në Seksionin 4 “*Procedura*”, pika 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të dokumenteve të tenderit për nënkriterin “*Cilesia e planveprimit në aspektin mjedisor*” jo vetëm mënyrën e llogaritjes me pikë në mënyrë të detajuar, informacion të qartë se si do të zhvillohet procesi i vlerësimit për të gjithë faktorët, që do të merren parasysh dhe metodologjinë që do të aplikohet për këtë nënkriter, dokumentacionin që do duhet të paraqesë çdo ofertues, por edhe formulën përkatëse të përllogaritjes së pikëve për këtë nënkriter, sikurse përcaktohet në pikës 7 të nenit 45 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, në mënyrë që të kemi një vlerësim sa më të drejtë, në mënyrë krahasimore me dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, pasi pikëzimi i papërshtatshëm do të shkaktonte probleme gjatë kryerjes së vlerësimit.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për këtë nënkriter qëndron.

III.2.14.2. Lidhur me përcaktimet e bëra nga autoriteti kontraktor për nënkriterin “*Cilesia e planveprimit në aspektin social*”, Komisioni konstaton se vlerësimi me pikë për këtë nënkriter do të bëhet duke analizuar përfshirjen e elementeve të argumentimit të publikuar në Seksionin 4 “*Procedura*”, pika 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të dokumenteve të tenderit, duke mos u kufizuar vetëm në to dhe konkretisht me 0 (zero) pikë do të vlerësohen operatorët ekonomikë ofertues të cilët **nuk paraqesin fare planveprim në aspektin social ose që paraqesin një planveprimi në aspektin social që nuk përmban asnjë të dhënë të përshkruar në argumentimin e këtij kriteri të përmendur më sipër**, ndërsa pikëzimi 1-5 pike do të bëhet duke u bazuar në cilësinë dhe përshkrimin e elementëve të argumentimit.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga përcaktimet e autoritetit kontraktor, Komisioni gjykon se enti prokurues për këtë nënkriter ka përcaktuar vetëm rastet kur ky kriter vlerësohet me 0 (zero) pikë, ndërsa për rastet kur ofertuesit e njëpasnjëshëm paraqesin **një planveprimi në aspektin social të vlefshëm nuk ka përcaktuar** mënyrën e llogaritjes së pikëve që do ti vlerësojë secilin ofertues të njëpasnjëshëm për këtë nënkriter, duke mospërcaktuar jo vetëm mënyrën e llogaritjes me pikë **të hartimit të strategjive për parandalimin e teprimit të ushqimeve, duke përfshirë (por jo vetëm) garantimin e ruajtjes së ushqimit në kushtet e duhura, magazinim efikas, blerje rregullisht në sasi të duhura të lëndës së parë me të cilat do të përgatiten dietat, angazhim të oferteusit në projekte sociale, etj.** Operatorin ekonomik me përvojë në dhurimin e produkteve ushqimore të cilët kanë qasje më sociale dhe ndikojnë drejtëpërdrejtë në prokurimin e qendrueshëm duke optimizuar shpenzimet me anë të shpërndarjes së ushqimeve për kategori sociale në pamundësi, pra dokumentacionin që secili ofertues duhet të paraqesë për të përmbushur këtë nënkriter, apo dhe detajimin se çfarë duhet të përmbajë metodologjia pasi vetëm në këtë mënyrë autoriteti do të mund të zbatojë parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit gjatë vlerësimit për secilin kriter, gjithashtu ajo çka është më e rëndësishmja rezulton se gjatë verifikimit të dokumentave standarte të tenderit enti prokurues nuk ka përcaktuar formulën që do të përdoret gjatë procesit të vlerësimit të ofertave për përlllogaritjen e pikëve për këtë nënkriter, sikurse përcaktohet në pikës 7 të nenit 45 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në Seksionin 4 “*Procedura*”, pika 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të dokumenteve të tenderit për nënkriterin “*Cilesia e planveprimit në aspektin social*” jo vetëm mënyrën e llogaritjes me pikë në mënyrë të detajuar, informacion të qartë se si do të zhvillohet procesi i vlerësimit për të gjithë faktorët, që do të merren parasysh dhe metodologjinë që do të aplikohet për këtë nënkriter, dokumentacionin që do duhet të paraqesë çdo ofertues, por edhe formulën përkatëse të përlllogaritjes së pikëve për këtë nënkriter, sikurse përcaktohet në pikës 7 të nenit 45 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, në mënyrë që të kemi një vlerësim sa më të drejtë, në mënyrë krahasimore me dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, pasi pikëzimi i papërshtatshëm do të shkaktonte probleme gjatë kryerjes së vlerësimit.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për këtë nënkriter qëndron.

III.2.14.3. Lidhur me përcaktimet e bëra nga autoriteti kontraktor për nënkriterin “*Plani i veprimit per ambalazhimin e panevojshem dhe metodologjia e mbledhjes dhe perpunimit te ketij ambalazhi*” të kriterit “*Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm*”, Komisioni konstaton se vlerësimi me pikë për këtë nënkriter do të bëhet duke analizuar përfshirjen e elementeve të argumentimit të publikuar në Seksionin 4 “Procedura”, pika 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të dokumenteve të tenderit, duke mos u kufizuar vetëm në to dhe konkretisht me 0 (zero) pikë do të vlerësohen operatorët ekonomikë ofertues të cilët **nuk paraqesin fare planveprim në aspektin social ose që paraqesin një planveprimi në aspektin social që nuk përmban asnjë të dhënë të përshkruar në argumentimin e këtij kriteri të përmendur më sipër**, ndërsa pikëzimi 1-5 pike do të bëhet duke u bazuar në cilësinë dhe përshkrimin e elementëve të argumentimit.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga përcaktimet e autoritetit kontraktor, Komisioni gjykon se enti prokurues për këtë nënkriter ka përcaktuar vetëm rastet kur ky kriter vlerësohet me 0 (zero) pikë, ndërsa për rastet kur ofertuesit e njëpasnjëshëm paraqesin **një plan veprimi per ambalazhimin e panevojshem dhe metodologjia e mbledhjes dhe perpunimit te ketij ambalazhi të vlefshëm nuk ka përcaktuar mënyrën e llogaritjes së pikëve që do ti vlerësojë secilin ofertues të njëpasnjëshëm për këtë nënkriter**, duke mospërcaktuar jo vetëm mënyrën e llogaritjes me pikë të **përpilimit të inventarit të mbetjeve: duke analizuar të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve të tjera (përveç mbetjeve ushqimore), të reduktimit të mbetjeve në blerjen e lëndëve të para, me të cilat do të përgatiten racionet (dietat): zgjedhja e llojit të duhur të paketimit për të reduktuar mbetjet (p.sh. paketim të ripërdorshëm), paketim të riciklueshëm dhe kthimi i paketimit për ripërdorim vetëm në raste kur kjo është e mundur dhe nuk cënon sigurinë e ushqimit, si dhe reduktimin e mbetjeve në shërbimin e kateringut: shmangia e artikujve me ambalazh dytësor të panevojshëm ose të tepërt, përdorimi i kontenitorëve që mund të rimbushen (për erëza), etj**, pra dokumentacionin që secili ofertues duhet të paraqesë për të përmbushur këtë nënkriter, apo dhe detajimin se çfarë duhet të përmbajë metodologjia pasi vetëm në këtë mënyrë autoriteti do të mund të zbatojë parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit gjatë vlerësimit për secilin kriter, gjithashtu ajo çka është më e rëndësishmja rezulton se gjatë verifikimit të dokumentave standarte të tenderit enti prokurues nuk ka përcaktuar formulën që do të përdoret gjatë procesit të vlerësimit të ofertave për përlllogaritjen e pikëve për këtë nënkriter, sikurse përcaktohet në pikës 7 të nenit 45 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në Seksionin 4 “Procedura”, pika 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të dokumenteve të tenderit për nënkriterin “*Plani i veprimit per ambalazhimin e panevojshem dhe metodologjia e mbledhjes dhe perpunimit te ketij ambalazhi*” jo vetëm mënyrën e llogaritjes me pikë në mënyrë të detajuar, informacion të qartë se si do të zhvillohet procesi i vlerësimit për të gjithë faktorët, që do të merren parasysh dhe metodologjinë që do të aplikohet për këtë nënkriter, dokumentacionin që do duhet të paraqesë çdo ofertues, por edhe formulën përkatëse të përlllogaritjes së pikëve për këtë nënkriter, sikurse përcaktohet në pikës 7 të nenit

45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në mënyrë që të kemi një vlerësim sa më të drejtë, në mënyrë krahasimore me dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë pjsëmarrës, pasi pikëzimi i papërshtatshëm do të shkaktonte probleme gjatë kryerjes së vlerësimit.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për këtë nënkriter qëndron.

III.2.14.4. Lidhur me përcaktimet e bëra nga autoriteti kontraktor për nënkriterin “**Lloji i paketimit i zgjedhur i cili mund të jete i biodegradueshem ose i riciklueshem.**” të kriterit “**Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm**”, Komisioni konstaton se vlerësimi me pikë për këtë nënkriter do të bëhet duke analizuar përfshirjen e elementeve të argumentimit të publikuar në Seksionin 4 “Procedura”, pika 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të dokumenteve të tenderit, duke mos u kufizuar vetëm në to dhe konkretisht me 0 (zero) pikë do të vlerësohen operatorët ekonomikë ofertues të cilët **nuk paraqesin asnjë dokument, ose asnjë dokument që te vertetoje se paketimi i propozuar nuk ka elemente pro mjedisore**, ndërsa pikëzimi 1-5 pike do të vlerësohet bazuar në dokumentacion faktik sic është një marrëdhënie e dëshmuar me një prodhues apo distributor të paketimeve ushqimore. Ku marrëdhënia është me distributor të autorizuar do të vërtetohet marrëdhënia e distributorit me prodhuesin. Në aktet provuese duhet të përshkruhet natyra e paketimit nëse është e riciklueshme, e biodegradueshme apo e ndonjë lloji tjetër, miqësore me mjedisin.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga përcaktimet e autoritetit kontraktor, Komisioni gjykon se enti prokurues për këtë nënkriter ka përcaktuar vetëm rastet kur ky kriter vlerësohet me 0 (zero) pikë, ndërsa për rastet kur ofertuesit e njëpasnjëshëm paraqesin **dokumentacion faktik nuk ka përcaktuar** mënyrën e llogaritjes së pikëve që do ti vlerësojë secilin ofertues të njëpasnjëshëm për këtë nënkriter, duke mospërcaktuar jo vetëm mënyrën e llogaritjes me pikë të **përpilimit të inventarit të mbetjeve: duke analizuar të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve të tjera (përveç mbetjeve ushqimore), të reduktimit të mbetjeve në blerjen e lëndëve të para, me të cilat do të përgatiten racionet (dietat): zgjedhja e llojit të duhur të paketimit për të reduktuar mbetjet (p.sh. paketim të ripërdorshëm), paketim të riciklueshëm dhe kthimi i paketimit për ripërdorim vetëm në raste kur kjo është e mundur dhe nuk cënon sigurinë e ushqimit, si dhe reduktimin e mbetjeve në shërbimin e kateringut: shmangia e artikujve me ambalazh dytësor të panevojshëm ose të tepërt, përdorimi i kontenitorëve që mund të rimbushen (për erëza), etj**, pra dokumentacionin që secili ofertues duhet të paraqesë për të përmbushur këtë nënkriter, apo dhe detajimin se çfarë duhet të përmbajë metodologjia pasi vetëm në këtë mënyrë autoriteti do të mund të zbatojë parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit gjatë vlerësimit për secilin kriter, gjithashtu ajo çka është më e rëndësishmja rezulton se gjatë verifikimit të dokumentave standarte të tenderit enti prokurues nuk ka përcaktuar formulën që do të përdoret gjatë procesit të vlerësimit të ofertave për përllogaritjen e pikëve për këtë nënkriter, sikurse përcaktohet në pikës 7 të nenit 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në Seksionin 4 “*Procedura*”, pika 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të dokumenteve të tenderit për nënkriterin “***Lloji i paketimit i zgjedhur i cili mund të jete i biodegradueshem ose i riciklueshem***” jo vetëm mënyrën e llogaritjes me pikë në mënyrë të detajuar, informacion të qartë se si do të zhvillohet procesi i vlerësimit për të gjithë faktorët, që do të merren parasysh dhe metodologjinë që do të aplikohet për këtë nënkriter, dokumentacionin që do duhet të paraqesë çdo ofertues, por edhe formulën përkatëse të përlllogaritjes së pikëve për këtë nënkriter, sikurse përcaktohet në pikës 7 të nenit 45 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, në mënyrë që të kemi një vlerësim sa më të drejtë, në mënyrë krahasimore me dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë pjsëmarrës, pasi pikëzimi i papërshtatshëm do të shkaktonte probleme gjatë kryerjes së vlerësimit.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për këtë nënkriter qëndron.

III.2.14.5. Lidhur me përcaktimet e bëra nga autoriteti kontraktor për kriterin “***Transporti ekologjik***”, Komisioni konstaton se vlerësimi me pikë për këtë kriter do të bëhet duke analizuar përfshirjen e elementeve të argumentimit të publikuar në Seksionin 4 “*Procedura*”, pika 4.4 “*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*” të dokumenteve të tenderit, duke mos u kufizuar vetëm në to dhe konkretisht me 10 (dhjetë) pikë do të vlerësohen ata operatorë ekonomikë të cilët disponojnë automjete elektrike, ndërsa pikëzimi me 5 (pesë) pikë do të jepet për ata operatorë që disponojnë automjete hybrid, ndërsa pikëzimi 0 (zero) pikë deri në 4 (katër) pikë do të jepet për ata operatorë ekonomikë që disponojnë automjete emetimi i të cilave është i lartë.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga përcaktimet e autoritetit kontraktor, Komisioni gjykon se enti prokurues për këtë kriter ka përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit rastin sesi do të vlerësohet me pikë ky nënkriter, pra nëse operatori ekonomik disponon një automjet elektrik vlerësohet me 10 (dhjetë) pikë, nëse disponon një mjet hybrid vlerësohet me 5 (pesë) pikë dhe nëse disponon automjet tjetër (të ndryshëm nga automjeti elektrik apo automjeti hybrid) me emetim **të ulët do të vlerësohet me 4 (katër) pikë ndërsa kur është me emetim të lartë do të vlerësohet me 0 (zero) pikë**, ndërkohë që nuk ka përcaktar se për çfarë lloj emëtimesh bëhet fjalë në këtë nënkriter, si dhe nuk ka përcaktuar nivelin e emëtimit për termin “Emetim i ulët” dhe nivelin e emëtimit për termin “Emetim i lartë”.

Gjithashtu Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar dokumentacionin që do të dorëzojë operatori ekonomik ofertues për të vërtetuar nivelin e emëtimit që ka automjeti që disponon operatori ekonomik ofertues në përmbushje të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 9 “*Formulari i Krihereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*”, Loti 1: “*Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi (Catering) në S.U.O.Gj “Mbretëresha Geraldinë”*” të dokumentave të tenderit objekt ankimi.

Ndërkohë që në kriterin e veçantë të kualifikimit pika 2.3.4 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 9 “*Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*”, Loti 2: “*Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi (Catering) në S.U.O.Gj “Mbretëresha Geraldinë”*” të dokumentave të tenderit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar se shërbimi i transportit të ushqimit do të bëhet me mjetë frigoriferik, ku referuar nenit 47 “*Klasifikimi i mjeteve rrugore*” të Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998 “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar ligjvënësi ka përcaktuar llojet dhe kategoritë e mjeteve që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, ndërsa në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 633, datë 26.10.2018 “*Për Masat Kundër Ndotjes së Ajrit nga Shkarkimet e Mjeteve Motorike dhe Reduktimit të Shkarkimeve në Ajër të Ndotësve të Gaztë dhe të Lëndës së Ngurtë*” nga Motorët me Ndezje Pozitive dhe ata me Ndezje me Kompresion që Djegin Gaz Natyror apo të Lëngshëm për Përdorim në Automjete”, i ndryshuar, të dalë në zbatim të nenit 79 “*Kontrrolli teknik*”, pika 1, të Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998 “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, ligjvënësi ka përcaktuar nivelet maksimale të emëtimit “*Ndotësve të gaztë*” që duhet të plotësojnë këto mjetë për t’u lejuar që të qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, ndërkohë që referuar kësaj baze ligjore, Komisioni gjykon se nuk ka asnjë term “*Transport të gjelbër*”, por ka vetëm kategorizim mjetesh dhe nivele maksimale të “*Ndotësve të gaztë*” (në rastin e mjeteve me djegje të brendshme).

Për më tepër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar se përse automjetet elektrike vlerëson me 10 (dhjetë) pikë, ndërkohë që automjetet hybrid vlerësohen më 5 (pesë) pikë dhe për më tepër automjetet me djegje të brendshme në varësi të nivelit të emëtimit vlerësohen nga 0 (zero) pikë deri në 4 (katër) pikë, ku referuar bazës ligjore të sipërpërmendur mjetet me djegje të brendshme nëse plotësojnë nivelet maksimale të emëtimit të “*Ndotësve të gaztë*” lejohen që të qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar mënyrën e llogaritjes së pikëve që do të vlerësojë secilin ofertues të njëpasnjëshëm për këtë nënkriter në rastin e disponimit të një mjeti transporti frigoriferik me djegje të brendshme, lidhur me përcaktimin e nivelit të emëtimit **të ulët dhe përcaktimin e nivelit të emëtimit të lartë**, si dhe nuk ka përcaktuar vetëm mënyrën e llogaritjes me pikë **të përdorimit të mjeteve të transportit frigoriferik të llojit elektrik ose hybrid ose çdo lloj tjetër automjeti transporti i cili ka emëtimin më të ulët apo të lartë të të “Ndotësve të gaztë” të provuar me dokumentacion**, pra dokumentacionin që secili ofertues duhet të paraqesë për të përmbushur këtë nënkriter, apo dhe detajimin se çfarë duhet të përmbajë dokumentacioni, pasi vetëm në këtë mënyrë autoriteti do të mund të zbatojë parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit gjatë vlerësimit për këtë nënkriter.

Gjithashtu ajo çka është më e rëndësishmja rezulton se gjatë verifikimit të dokumentave standarte të tenderit enti prokurues nuk ka përcaktuar formulën që do të përdoret gjatë procesit të vlerësimit të ofertave për përlllogaritjen e pikëve për këtë kriter, sikurse përcaktohet në pikës 7 të nenit 45 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të argumentojë në Seksionin 4 “Procedura”, pika 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të dokumenteve të tenderit për nënkriterin “**Transporti ekologjik**” vlerësimin me pikë për secilin nga rastet e disponimit nga ana e operatorëve ekonomikë të mjetit të transportit elektrik, hybrid apo me djegie të brendshme, duke patur parasysh përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 633, datë 26.10.2018 “Për Masat Kundër Ndotjes së Ajrit nga Shkarkimet e Mjeteve Motorike dhe Reduktimin e Shkarkimeve në Ajër të Ndotësve të Gaztë dhe të Lëndës së Ngurtë Pezull nga Motorët me Ndezje Pozitive dhe ata me Ndezje me Kompresion që Djegin Gaz Natyror apo të Lëngshëm për Përdorim në Automjete”, i ndryshuar, si dhe duhet të dokumentacionin që do duhet të paraqesë çdo ofertues për të vertetuar llojin e mjetit të transporti (përsa i përket llojit elektrik, hybrid apo me djegie të brendshme) dhe nivelin maksimal të “Ndotësve të gaztë” **në rastin kur disponon një mjet me djegie të brendshme**, por edhe formulën përkatëse të përlllogaritjes së pikëve për këtë nënkriter, sikurse përcaktohet në pikës 7 të nenit 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në mënyrë që të kemi një vlerësim sa më të drejtë, në mënyrë krahasimore me dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë pjsëmarrës, pasi pikëzimi i papërshtatshëm do të shkaktonte probleme gjatë kryerjes së vlerësimit.

Për këtë arsye, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar shërbime”, me Nr. REF-51688-06-18-2025, me objekt Loti 1 “Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi (Catering) në S.U.O.Gj “Mbretëresha Geraldinë”, me fond limit: 185,219,458 (njëqind e tetëdhjetë e pesë milion e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ose 1,888,452.88 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e tetë) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

2. Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “*Dajti Park 2007*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mezini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

